FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 135

Tiranë – E hënë, 20 korrik 2020

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 550, datë 15.7.2020	Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre.....	7947
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 15.7.2020	Për miratimin e Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, 2020–2024, dhe të planit të veprimit, për periudhën 2020–2022.....	8107

VENDIM
Nr. 550, datë 15.7.2020

PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË KËRKESËS PËR MIRATIMIN, NË PARIM, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR, E LEJES/AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM BURIMI UJOR, VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, VEPRIMTARI NË SHTRATIN E BURIMIT UJOR, SHKARKIME TË LËNGSHME, PËRDORIMIN DHE RIPËRDORIMIN E UJËRAVE TË PËRDORURA, TË NDOTURA, TË DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, TË PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT E TË VENDIMMARRJES, TË FORMATEVE TË LEJES, TË AUTORIZIMIT, TË KUSHTEVE TË POSAÇME DHE TË AFATEVE TË VLEFSHMËRISË SË TYRE

Në mbështetje të neni 100 të Kushtetutës dhe të neneve 41, pika 3, 42, pika 5, 44, pika 2, 50, pika 6, dhe 53, pika 3, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij vendimi është miratimi i formularëve të kërkesës për miratim, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, të lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit të kërkesave, vendimmarrjes, rinovimit, pezullimit, ndryshimit të tyre, formateve të lejes/autorizimit, kushteve të përgjithshme e të posaçme të tyre dhe afateve të vlefshmërisë së tyre.

2. Akronimet dhe termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "AMBU", Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

b) "KKU", Këshilli Kombëtar i Ujit;

c) "KBU", Këshilli i Basenit Ujor;

ç) "ZABU", Zyra e Administrimit të Basenit Ujor;

d) "Person fizik", personi fizik në kuptim të Kodit Civil dhe personi që ushtron veprimtari tregtare, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik;

dh) "Leje/autorizim" është leja/autorizimi i miratuar nga KKU-ja ose KBU-ja për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura dhe të ndotura.

II. FORMULARËT E KËRKESËS PËR MIRATIMIN NË PARIM, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË BURIMIT UJOR, TË LEJES / AUTORIZIMIT, RINOVIMIT, NDRYSHIMIT DHE PEZULLIMIT TË TYRE, DOKUMENTET SHOQËRUESE, FORMATET E LEJEVE/AUTORIZIMEVE, KUSHTET E POSAÇME

3. Miratimin e formularëve të kërkesës për secilën veprimtari, për të cilën kërkohet miratim në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, leje/autorizim, rinovim, ndryshim dhe pezullim të tyre, të dokumentacionit teknik e ligjor shoqërues sipas shtojcës 1 dhe të përmbajtjes së dokumentacionit teknik sipas shtojcës 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Miratimin e formateve të lejes/autorizimit dhe të kushteve të posaçme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. PARAQITJA DHE PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR MIRATIM NË PARIM PËR DHËNIEN ME KONCESION TË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR, LEJE/AUTORIZIM

5. Autoriteti kontraktor, që kërkon miratim në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor nga KKU-ja, paraqet kërkesën zyrtare pranë AMBU-së, të shoqëruar me formularin e kërkesës për miratimin në parim të dhënies me koncesion të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor ose nëntokësor të plotësuar, si dhe dokumentacionin teknik e ligjor, të parashikuar në formular.

6. Çdo person fizik, juridik, privat apo shtetëror, në vijim kërkues, i cili kërkon leje/autorizim, pezullimin apo ndryshimin e lejes/autorizimit,

paraqet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij kërkesën në sistemin elektronik të lejeve e autorizimeve për përdorim burimi ujor, në vijim sistemi elektronik.

Kërkesa paraqitet nëpërmjet plotësimit të formularit të të dhënave të përgjithshme, ngarkimit në sistemin elektronik të formularit të kërkesës për veprimtarinë përkatëse, të dokumentacionit teknik e ligjor shoqërues të përcaktuar në të dhe të dokumentit që provon pagesën e tarifës së kërkesës. Dokumentacioni teknik që ngarkohet duhet të jetë i nënshkruar me firmë elektronike nga subjekti hartues i licencuar.

7. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues shqyrtohet nga AMBU-ja.

8. AMBU-ja shqyrton formalisht, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, nëse është paraqitur i gjithë dokumentacioni teknik e ligjor. Ky afat fillon nga dita e nesërme e paraqitjes së kërkesës për miratim në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor pranë AMBU-së ose e regjistrimit të kërkesës për leje/autorizim në sistemin elektronik. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, AMBU-ja njofton kërkuesin që, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, të plotësojë dokumentacionin. Me dërgimin e njoftimit si më sipër, ndërpritet llogaritja e afatit të shqyrtimit të kërkesës deri në plotësimin e dokumentacionit dhe fillon një afat i ri. Nëse kërkuesi nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit të caktuar, nëse dokumentacioni i ngarkuar në sistem ka përsëri mangësi, atëherë AMBU-ja merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës.

9. Në mungesë njoftimi për mangësi në dokumentacion, brenda afatit të përcaktuar në pikën 8, të këtij kreu, AMBU-ja ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin teknik e ligjor të kërkesës.

10. Pasi kërkuesi ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm teknik e ligjor, të përcaktuar në formularët e kërkesës për secilën veprimtari dhe ka paguar tarifën e kërkesës, AMBU-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, përfundon shqyrtimin teknik e ligjor të kërkesës.

Nëse gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës AMBU-ja konstaton mangësi në përmbajtje, mospërputhje të dhënash teknike dhe/ose ligjore, ose vlerëson se është e nevojshme që të kryhen ndryshime në projektin e paraqitur, njofton kërkuesin për plotësimin, korrigjimin, ndryshimin e dokumentacionit ose të projektit duke dhënë arsyet përkatëse. Këto veprime duhet të kryhen nga kërkuesi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga njoftimi. Ky afat zbatohet për plotësimin apo saktësimin e dokumenteve për të cilat nuk kërkohet miratimi nga organet e administratës shtetërore ose të enteve publike. Nëse për plotësimin, ndryshimin e dokumentacionit ose të projektit kërkohet miratim nga organet e administratës shtetërore ose të enteve publike, atëherë afati për plotësimin e tyre është brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike. Me dërgimin e njoftimit si më sipër, ndërpritet llogaritja e afatit të shqyrtimit teknik e ligjor të kërkesës deri në plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesi dhe fillon një afat i ri.

Nëse plotësimi, korrigjimi, ndryshimi i dokumentacionit ose i projektit nuk është i plotë, atëherë kërkuesi njoftohet dhe një herë për kryerjen e veprimeve të nevojshme, sipas afateve të përcaktuara në paragrafin 2 e 3, të kësaj pike. Në rast se ndryshimet nuk ngarkohen në sistemin elektronik brenda afateve të përcaktuara apo ngarkohen përsëri me mangësi, atëherë AMBU-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës.

11. Pas shqyrtimit të kërkesës sipas pikave 8, 9 e 10, të këtij kreu, AMBU-ja ia dërgon për mendim, kërkesën për leje/autorizim, nëpërmjet sistemit elektronik, institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në KKU, në rastet kur ligji parashikon se miratimi është kompetencë e këtij organi, ose kryetarit të KBU-së, përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe institucioneve që përfaqësohen me anëtarë në këtë organ, në rastet kur miratimi është kompetencë e KBU-së. Institucionet dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit duhet të shprehin mendimin e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

AMBU-ja ka të drejtë t'ia dërgojë për mendim kërkesën për leje/autorizim dhe institucioneve të tjera shtetërore ose operatorëve të shërbimeve publike, të cilët brenda 10 (dhjetë) ditëve pune kanë detyrimin të japin informacion apo pëlqim lidhur me kërkesën.

Institucionet shtetërore, që u dërgohet kërkesa për mendim, shprehen për përputhshmërinë e kërkesës me politikat, strategjitë, projektet dhe legjislacionin që rregullon fushën e tyre të përgjegjësisë shtetërore. Anëtari i KBU-së, që përfaqëson grupet e interesit, shprehet për cenimin ose jo të interesit të grupit që përfaqëson.

Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, prezumohet që institucioni ose grupi i interesit nuk ka komente për kërkesën dhe është dakord të paraqitet për shqyrtim në mbledhjen e KKU-së ose KBU-së. Në këtë rast, AMBU-ja ka detyrimin të vijojë me paraqitjen e saj për miratim në organin kompetent.

12. Nëse gjatë procesit të bashkërendimit të kërkesës, sipas pikës 11, të këtij kreu, një nga institucionet kundërshton dhënien e lejes/autorizimit, atëherë AMBU-ja, pasi e vlerëson këtë mendim nëse është brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucionit përkatës, i kërkon kërkuesit të plotësojë mangësitë e konstatuara brenda 10 (dhjetë) ditëve pune. Nëse kundërshtimi bëhet për arsye të tjera, AMBU-ja pasqyron arsyet e kundërshtimit në raportin teknik e ligjor që i përcillet organit miratues pa kërkuar plotësime nga subjekti.

Nëse plotësimet e kërkuara nuk ngarkohen në sistemin elektronik brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e parë apo ngarkohen përsëri me mangësi, atëherë AMBU-ja njofton dhe një herë kërkuesin për plotësimin e dokumentacionit brenda 5 (pesë) ditëve pune. Nëse plotësimet nuk ngarkohen në sistemin elektronik ose janë përsëri me mangësi, atëherë AMBU-ja merr vendim për refuzimin e kërkesës.

13. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe bashkërendimit të saj sipas pikave 8, 9, 10,11 e 12, të këtij kreu, AMBU-ja përgatit raportin e vlerësimit teknik e ligjor dhe e përcjell për vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Ujit ose në Këshillin e Basenit Ujor, sipas kompetencave të përcaktuara në ligj për miratimin e veprimtarisë përkatëse. Në këtë rast, AMBU-ja njofton subjektin nëpërmjet sistemit elektronik për përfundimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe për përcjelljen e saj pranë organit kompetent.

IV. VENDIMMARRJA DHE HYRJA NË FUQI E VENDIMIT

14. KKU-ja, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike dhe KBU-ja brenda 45 ditëve kalendarike nga paraqitja e raportit të vlerësimit teknik e ligjor nga AMBU-ja, marrin vendim për:

a) miratimin në parim të kërkesës për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor;

b) miratimin e lejes/autorizimit sipas kërkesës së paraqitur;

c) miratimin me ndryshime nga kërkesa e paraqitur;

ç) refuzimin e kërkesës;

d) rinovimin e afatit të lejes/autorizimit;

dh) ndryshimin e vendimit të dhënies së lejes/autorizimit;

e) pezullimin e lejes/autorizimit;

ë) anulimin ose shfuqizimin e vendimit të dhënies së lejes/autorizimit.

15. Vendimi i KKU-së dhe i KBU-së hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së tij kërkuesit ose titullarit të lejes/autorizimit.

16. Vendimi i KKU-së dhe i KBU-së i njoftohet kërkuesit nëpërmjet sistemit elektronik, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e marrjes së vendimit.

17. Në rastin e miratimit, rinovimit, lejes/autorizimit ose ndryshimit me kërkesë të titullarit, kërkuesi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, duhet të ngarkojë aktet që provojnë pagimin e tarifës së shpenzimeve administrative për dhënien e lejes/autorizimit.

18. AMBU-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga ngarkimi në sistem i dokumentit të pagesës së shpenzimeve administrative, plotëson formatin e lejes/autorizimit dhe e ngarkon në sistemin elektronik bashkë me vendimin e KKU-së ose KBU-së, në përputhje me kriteret e dokumentit elektronik. Kërkuesi ka të drejtë të kërkojë edhe dorëzimin fizik të formatit të lejes/autorizimit dhe të vendimit për miratimin e kërkesës.

19. Mospagimi i tarifës së shpenzimeve administrative të dhënies së lejes/autorizimit, rinovimit ose ndryshimit me kërkesë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 17, sjell si pasojë pushimin e fuqisë juridike të vendimit të miratimit.

V. RINOVIMI, PEZULLIMI, NDRYSHIMI, ANULIMI DHE SHFUQIZIMI I LEJES/ AUTORIZIMIT

20. Autoriteti kontraktor, të cilit i është miratuar në parim nga KKU-ja kërkesa për nisjen e një procedure koncesioni ose subjekti i pajisur me leje/autorizim, në përfundim të afatit të vlefshmërisë së tyre sipas pikave 27 e 28, të kreut VI, kërkon rinovimin e afatit të vlefshmërisë nëse nuk ndryshon llojin e veprimtarisë, koordinatat e ushtrimit të veprimtarisë dhe sasinë e ujit që kërkon të përdorë. Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre elementeve, titullari i saj duhet të paraqesë

kërkesë të re, për miratimin në parim, për nisjen e një procedure koncesioni ose për leje/autorizim.

21. Subjekti i pajisur me leje/autorizim, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë, njofton AMBU-në nëse do të kërkojë rinovimin e tyre. Nëse ky njoftim nuk bëhet nga subjekti, AMBU-ja njofton titullarin e saj, jo më vonë se 5 (pesë) muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë, të shprehet me shkrim nëse do të kërkojë rinovimin.

22. Kërkesa për rinovimin e lejes/autorizimit paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik, sipas formularit përkatës të parashikuar në shtojcën 1, të këtij vendimi, duke plotësuar dokumentacionin e kërkuar. Shqyrtimi i kërkesës për rinovim bëhen sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi.

23. Pezullimi i lejes/autorizimit vendoset nga organi miratues, kryesisht ose me kërkesë të AMBU-së, për shkaqet e parashikuara në nenin 54, të ligjit 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, sipas procedurave të parashikuara në ligjin që rregullon veprimtarinë e dhënies së licencave, lejeve dhe autorizimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi.

Nëse pezullimi kërkohet nga mbajtësi i titullit, kërkesa paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik sipas formularit 47, të shtojcës 1, të këtij vendimi, duke plotësuar dokumentacionin e kërkuar. Shqyrtimi i kërkesës së titullarit për pezullim bëhet sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi. Nëse shkaku për të cilën titullari kërkon pezullimin e lejes/autorizimit nuk është i mbështetur në ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, ose në legjislacionin në fuqi, atëherë AMBU-ja merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës.

24. Ndryshimi i lejes/autorizimit vendoset kryesisht nga organi miratues ose me kërkesë të AMBU-së, për shkaqet e parashikuara në nenin 54, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, sipas procedurave të parashikuara në ligjin që rregullon veprimtarinë e dhënies së licencave, lejeve dhe autorizimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi.

Nëse ndryshimi kërkohet nga mbajtësi i titullit, kërkesa paraqitet nëpërmjet sistemit elektronik sipas formularit 48, të shtojcës 1, të këtij vendimi, duke plotësuar dokumentacionin e kërkuar. Nëse mbajtësi i titullit kërkon të ndryshojë llojin e veprimtarisë, vendin e ushtrimit ose të rrisë sasinë e ujit që kërkon të përdorë, atëherë duhet të paraqesë kërkesë të re për leje/autorizim sipas llojit të veprimtarisë që kërkon. Shqyrtimi i kërkesës së titullarit për ndryshimin e lejes/autorizimit bëhet sipas procedurës dhe afateve të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi.

25. Anulimi, shfuqizimi i lejes/autorizimit bëhen për shkaqet e parashikuara në nenin 55, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, sipas procedurave të parashikuara në ligjin që rregullon veprimtarinë e dhënies së licencave, lejeve dhe autorizimeve në Republikën e Shqipërisë dhe në legjislacionin në fuqi.

VI. HYRJA NË FUQI E LEJES/ AUTORIZIMIT, AFATET E VLEFSHMËRISË

26. Leja/autorizimi për përdorimin e burimit ujor hyn në fuqi vetëm pas publikimit të saj në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

27. Afati i vlefshmërisë së miratimit në parim për nisjen e një procedure koncesioni, e lejes/autorizimit për përdorimin e burimeve ujore sipërfaqësore, nëntokësore dhe shkarkimeve të lëngshme është, si më poshtë vijon:

a) miratimi në parim për nisjen e një procedure koncesioni jepet për një periudhë kohore 2 vjet;

b) autorizimi jepet për një periudhë kohore 5 vjet;

c) leja jepet për një periudhë kohore 5 vjet;

ç) në rastet e përdorimit të burimit ujor me koncesion ose kur përdorimi i burimit ujor i shërben kryerjes së një veprimtarie me koncesion, afati është në përputhje me afatet e koncesionit;

d) në rastin e investimeve strategjike, afati i lejes/autorizimit është në përputhje me afatin për të cilin është dhënë statusi "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".

28. Afati i vlefshmërisë së lejes/autorizimit për veprimtari ndërtimore në brigje dhe veprimtari në shtratin e burimit ujor është, si më poshtë vijon:

a) autorizimi i posaçëm për përdorim burimi ujor, për veprimtari ndërtimi, rindërtimi ose shembjen e objekteve, për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, është i

vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare, nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren;

b) autorizimi për përdorim burimi ujor, për veprimtari ndërtimore në brigje, është i vlefshëm për një periudhë 2-vjeçare, nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren;

c) autorizimi për veprimtari mbrojtëse të përkohshme në rast emergjence është sipas kërkesës së paraqitur nga strukturat e ngritura për përballimin e emergjencave civile;

ç) leja për përdorim burimi ujor, për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale, veprave mbrojtëse në det dhe ishujve artificialë në det, është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare, nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren;

d) leja për shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë, është sipas grafikut të punimeve, por jo më shumë se 3 vjet;

dh) leja për rehabilitimin e trupave ujorë është sipas grafikut të punimeve;

e) leja/autorizimi për veprimtari të tjera në brigje dhe shtratin e burimit ujor është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare, nga data e miratimit deri në fillimin e zbatimit në terren.

VII. DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

29. Kërkesa për leje/autorizim do të paraqitet *on-line* nëpërmjet portalit *e-Albania*, nga data 1 tetor 2020.

30. Gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri në datën 1 tetor 2020, kërkesat për leje/autorizim dorëzohen në formë shkresore pranë ZABU-ve përkatëse sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

31. Kërkesat për leje/autorizim, gjatë periudhës 1 tetor 2020 deri në datën 31 dhjetor 2020, dorëzohen edhe në formë shkresore pranë ZABU-ve përkatëse, deri në funksionimin e plotë të sistemit elektronik "Aplikim për përdorim burimi ujor".

32. Pranimi, shqyrtimi i kërkesave për leje/autorizime, lëshimi i dokumenteve, si dhe bashkërendimi institucional, nga data 1 janar 2021, kryhen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik "Aplikim për përdorim burimi ujor".

33. Kërkesat e dorëzuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi shqyrtohen nga ZABU-të përkatëse, sipas kushteve të posaçme dhe dokumenteve shoqëruese të parashikuara në vendimin nr. 416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Në këtë rast, subjektet detyrohen të plotësojnë dokumentacionin teknik e ligjor brenda datës 31 dhjetor 2020. Nëse subjekti nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda këtij afati, atëherë duhet të paraqesë kërkesë të re nëpërmjet sistemit elektronik sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

34. Kërkesat për leje/autorizim të dorëzuara në formë shkresore, gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi deri në datën 31 dhjetor 2020, shqyrtohen sipas procedurës së parashikuar në kreun III.

35. Vendimi nr. 416, datë 13.5.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", shfuqizohet.

36. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit marrin të gjitha masat që, brenda datës 1 tetor 2020, të trajnojnë nëpunësit e caktuar si përdorues të sistemit elektronik "Aplikim për përdorim burimi ujor".

37. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FORMULARI 1

KËRKESË PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME KONCENSION TË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s) _____

Mënyra e Kaptazhit (specifiko)_____

Kapaciteti i grumbullues (m^3)_____

Volumi vjetor (m^3) _____

Prurja llogaritëse (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare shumëvjeçare e muajit më të thatë (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja ekologjike e propozuar (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Studimi hidrologjik;
2. Plan biznesi;
3. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
4. Projekt-ide të skemës së shfrytëzimit.

Kategoria*	**1**	**2**	**3**	**4**
K1 (*≤2 l/sek)*	√			√
K2 *(>2 l/sek)*	√	√	√	√

**në funksion të kategorizimit në këtë formular, përcaktohet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësohen nga secila kategori.*

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 2

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJË TË PIJSHËM
(*Sisteme të furnizmit me ujë të popullatës*)

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐
Lumë ☐
Liqen ☐
Rezervuar ☐
Përrua ☐
Kanal ☐
Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s) _____

Numri i banorëve që do t'i shërbehet_____

Norma e ujit për banor në ditë (l/b/d) _____

Mënyra e Kaptazhit (Specifiko) _____

Kapaciteti i depove (m^3) _____

Volumi vjetor i përdorur (m^3) _____

Prurja llogaritëse (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare shumëvjeçare e muajit më të thatë (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja ekologjike e propozuar (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Projekti i veprës së marrjes së ujit;
3. Projekti shkarkimit të ujit në trupin ujor pritës nga vepra e marrjes;
4. Planimetria e pikave të shkarkimit në trupat ujor të sistemit të kanalizimeve;
5. Projekti i trajtimit të ujit (nëse është i nevojshëm, në bazë të analizave);
6. Skema e linjës së dërgimit dhe pozicionimit të depove;
7. Studimi hidrologjik;
8. Plan biznesi;
9. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

10. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, në laboratorët referencë (SRSHP dhe /ose ISHP). Analizat duhet të përfshijnë gamën e parametrave sipas shtojcës I, të VKM 379, datë 25.05.2016 (ku duhet të paraqiten patjetër parametrat mikrobiologjikë, fiziko-kimikë dhe toksikologjikë (metalet e rënda, Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH-et) dhe Pesticidet Klororganike.)
11. Projekti i përcaktimit të saktë të brezave sanitarë të mbrojtjes.

Kategoria*	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**
K1 (*≤2 l/sek)*	√	√	√	√		√				√	√
K2 *(> 2 l/sek)*	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

***** **në funksion të kategorizimit në këtë formular, përcaktohet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësohen nga secila kategori.*

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 3

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s)_____

Mënyra e Kaptazhit (specifiko) _____

Kapaciteti i depove (m^3)_____

Volumi vjetor (m^3) _____

Prurja llogaritëse (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare shumëvjeçare e muajit më të thatë (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja ekologjike e propozuar (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Projekti i veprës së marrjes së ujit;
3. Projekti i trajtimit dhe ambalazhimit të ujit;
4. Projekti i dërgimit dhe depozitimit të ujit deri në impiantin e ambalazhimit;
5. Projekti i shkarkimit të ujit në trupin ujor pritës;
6. Studimi hidrologjik;
7. Plan biznesi;
8. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
9. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, në laboratorët referencë (SRSHP dhe/ose ISHP), të cilat duhet të përfshijnë gamën e parametrave mikrobiologjikë, fiziko-kimikë dhe toksikologjikë (metalet e rënda, Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH-et) dhe Pesticidet Klororganike.)
10. Projekti i përcaktimit të saktë të brezave sanitarë të mbrojtjes.

Kategoria *	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
K1 *< 150 shishe/orë; ≤1 l/sek)*	√	√	√				√	√	√	√
K2 *(≥150 shishe/ orë; > 1l/sek)*	√	√	√	√	√	√	√	√	√	√

**në funksion të kategorizimit në këtë formular, përcaktohet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësohen nga secila kategori.*

KËRKUESI: _____

(firma)

FORMULARI 4

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR UJITJE

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Sipërfaqja e parcelës që do të ujitet (ha): _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s) _____

Periudha e përdorimit te ujit për ujitje/Sasia për çdo muaj (l/s):

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja e ujit të kërkuar (l/sek)												

Mënyra e Kaptazhit (Specifiko) _____

Volumi vjetor (m³) _____

Prurja llogaritëse e skemës (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme) _____
Prurja mesatare shumëvjeçare e muajit më të thatë (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja ekologjike e propozuar (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

Lloji i kulturës bujqësore që do të ujitet_____

Lloji i tokës:

Argjilore ☐ Lym ☐ Ranore ☐ Tjetër ☐

Metoda e ujitjes: _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Projekti i veprës së marrjes së ujit;
3. Projekti (Planimetria) e skemës së ujitjes për zonën që do t'i shërbejë (të paktën deri në kanalet e dyta);
4. Projekti (Planimetria) e skemës së kullimit për zonën, të cilës do i shërbejë;

5. Studimi hidrologjik;
6. Plan biznesi;
7. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"; (nëse nuk është skemë ekzistuese)
8. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, në laboratorët referencë (SRSHP dhe /ose ISHP), të cilat duhet të përfshijnë gamën e parametrave mikrobiologjikë, fiziko-kimikë dhe toksikologjikë (metalet e rënda, Hidrokarbureve Policiklike Aromatike (PAH-et) dhe Pesticidet Klororganike.)

Kategoria*	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**
K1 *(≤5 ha;≤5 l/sek)*	√		√	√	√			
K2 *(>5 ha;>5 l/sek)*	√	√	√	√	√	√	√	√

**në funksion të kategorizimit në këtë formular, përcaktohet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësohen nga secila kategori.*

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 5

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË

FORMULARI 5/1

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË
(*në rastin e ujërave të rrjedhshëm*)

I. MARRJA E UJIT

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Lumë ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s) _____

Mënyra e Kaptazhit (Specifiko) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja mesatare e muajit më të thatë (l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja ekologjike e propozuar(l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

Volumi i vaskave (m^3) _____

Sipërfaqja totale (m²) _____
Thellësia mesatare (m) _____

Specifiko tipin e aktivitetit:

Aktivitet i ri ☐
Aktivitet ekzistues ☐

Specifiko emrin dhe origjinën e species që do të kultivohet:_____
_____

Specifiko llojin e ushqimit dhe normën/ton prodhim:_____
_____

A përfshin ky aktivitet përdorimin e substancave kimike (*përjashto përbërjen e ushqimit*):

PO ☐
JO ☐

Nëse PO specifiko llojin e tyre _____
_____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m³/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Kontrata e zhvillimit te aktivitetit.

2. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
3. Projekti i skemës së marrjes, qarkullimit dhe trajtimit të ujit;
4. Projekti shkarkimit të ujit në trupin ujor pritës;
5. Projekt konstruktiv i strukturave që do të përdoren dhe skemën e rrethimit të vaskave (me qëllim mos ndotjen e sipërfaqeve ujore përreth);
6. Studimi hidrologjik;
7. Plan biznesi;
8. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
9. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, të kryera në laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Kategoria *	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**
K1 (*≤5 ton/vit;≤5 l/sek)*	√	√	√	√	√		√	√	
K2 *(>5 ton/vit;>5l/sek)*	√	√	√	√	√	√	√	√	√

**në funksion të kategorizimit në këtë formular, përcaktohet edhe lista e dokumenteve që duhet të plotësohen nga secila kategori.*

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 5/2

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR AKUAKULTURË
(*në rastin e ujërave të qëndrueshëm*)

I. MARRJA E UJIT

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Volumi i ujit (m^3) _____

Volumi i vaskave (m^3) _____

Sipërfaqja totale (m^2) _____

Thellësia mesatare (m) _____

Specifiko tipin e aktivitetit:

Aktivitet i ri ☐

Aktivitet ekzistues ☐

Specifiko emrin dhe origjinën e species që do të kultivohet:_____
_____

Specifiko llojin e ushqimit dhe normën/ton prodhim:_____
_____

A përfshin ky aktivitet përdorimin e substancave kimike (*përjashto përbërjen e ushqimit*):

PO ☐

JO ☐

Nëse PO specifiko llojin e tyre _____

_____

II. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Kontrata e zhvillimit të aktivitetit;
2. Projekti i strukturave që do të përdoren për marrjen dhe qarkullimin e ujit dhe i rrethimit të vaskave;
3. Plan biznesi;
4. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
5. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, të kryera në laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

KËRKUESI: _____

(firma)

FORMULARI 6

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK

I. TË DHËNA KRYESORE PËR KONTRATËN DHE NDRYSHIMET E SAJ.

Tipi dhe nr. i Kontratës _____

Data e Kontratës_____

Titulli i Kontratës _____

Tarifa e kontratës (nëse ka)_____

Prodhimi vjetor i parashikuar (kWh/vit)_____

Numri i njësive të prodhimit_____

Fuqia e instaluar (kWh)_____

Llloji i HEC-it:_____

Lloji i Turbinës: _____

Vlera totale e investimit:_____

Kohëzgjatja e zbatimit të punimeve_____

Kohëzgjatja e kontratës _____

II. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Numri i veprave të marrjes:

1 ☐

2 ☐

3 ☐

Më shumë (specifiko sa) ☐

Prurja llogaritëse (m^3/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (m^3/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja ekologjike e propozuar (m^3/s) (ku është e aplikueshme)_____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

***Kordinatat e veprave të marrjes së ujit në sistemin KRGJSH:**

(Të paraqitet në pragun kapërderdhës të veprës së marrjes, ose saktëso kur nuk ka prag kapërderdhës)*

Vepra e Marrjes 1

Emërtimi i burimit ujor _____

X _____ Y _____ Z _____

Q mes/vjetore _____ m^3/s

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme) _____

Q llogaritëse _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes llogaritëse

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

Prurja llogaritëse (m^3/s)												

Q ekologjike e propozuar _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes ekologjike _____

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja ekologjike (m^3/s)												

Stacioni hidrometrik i monitorimit

X _____ Y _____ Z _____

Tipi i stacionit_____

Periodiciteti i matjeve ditore_____

Vepra e Marrjes 2

Emërtimi i burimit ujor _____

X _____ Y _____ Z _____

Q mes/vjetore _____ m^3/s

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme) _____

Q llogaritëse _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes llogaritëse

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja llogaritëse (m^3/s)												

Q ekologjike e propozuar _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes ekologjike _____

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

Prurja ekologjike (m^3/s)												

Stacioni hidrometrik i monitorimit

X _____ Y _____ Z _____

Tipi i stacionit_____

Periodiciteti i matjeve ditore_____

Vepra e Marrjes 3

Emërtimi i burimit ujor _____

X _____ Y _____ Z _____

Q mes/vjetore _____ m^3/s

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme) _____

Q llogaritëse _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes llogaritëse

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja llogaritëse (m^3/s)												

Q ekologjike e propozuar _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes ekologjike _____

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja ekologjike (m^3/s)												

Stacioni hidrometrik i monitorimit

X _____ Y _____ Z _____

Tipi i stacionit_____

Periodiciteti i matjeve ditore_____

Nëse ka më tepër Vepra të Marrjes, specifiko sa _____

(Plotëso më poshtë për secilën Vepër të Marrjes shtesë)

Vepra e Marrjes "n"

Emërtimi i burimit ujor _____

X _____ Y _____ Z _____

Q mes/vjetore _____ m^3/s

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme) _____

Q llogaritëse _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes llogaritëse

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja llogaritëse (m^3/s)												

Q ekologjike e propozuar _____ m^3/s

Shpërndarja brenda vjetore e prurjes ekologjike _____

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Prurja ekologjike (m^3/s)												

Stacioni hidrometrik i monitorimit

X _____ Y _____ Z _____

Tipi i stacionit_____

Periodiciteti i matjeve ditore_____

III. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH), ku kanali i largimit të godinës së HEC-it, takon trupin ujor pritës:

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (m^3/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Koordinatat e basenit të presionit:

X _____ Y _____ Z _____

Saktëso pikat ku janë marrë koordinatat: _____

Koordinatat e pikës së shkarkimit nga baseni, ku takon trupin ujor pritës

X _____ Y _____ Z _____

Kapaciteti i shkarkimit (m^3/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë)_____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

IV. TË DHËNAT E PROJEKTIT.

Tipi i veprës së marrjes _____

Gjatësia e derivacionit _____m

Në rast dige specifiko:

Lartësia e digës _____m

Gjerësia e digës _____m

Përshkueshmëria e digës_____

Lloji i digës sipas ndërtimit_____

Gjatësia e kurorës së digës_____ m

Niveli i ujit në bjefin e sipërm_____

Niveli i ujit në bjefin e poshtëm_____

Koordinatat e pozicionimit të prerjes së akseve të digës:

X _____ Y _____ Z _____

Rezevuari do të ndërtohet në _____(burim ujor), degë e lumit_____.

Sipërfaqja e rezervuarit në nivelin normal të ujit (m^2)_____

Volumi total i rezervuarit (m^3)_____

Volumi i vdekur i rezervuarit (m^3)_____

Volumi përpunues i rezervuarit (m^3)_____

V. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Studimi hidrologjik/Studimi hidrogjeologjik (nëse vepra e marrjes bëhet në dalje të burimeve);
3. Oponenca e studimit hidrogjeologjik nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH); (nëse vepra e marrjes bëhet në dalje të burimeve);
4. Kontrata për ushtrimin e aktivitetit;
5. Miratimi i projektit nga Institucioni Kontraktues, shoqëruar me oponencën e projektit dhe projektin e vulosur nga AKBN;
6. Miratimi nga Këshilli Kombëtar Digave të Mëdha (në rastin e digave të cilat klasifikohen të mëdha, të shqyrtohen nga KKDM,sipas legjislacionit në fuqi);
7. Projekti i zbatimit (i cili duhet të përmbajë minimalisht : Projekti i veprës së marrjes së ujit /Projekti i digës në rastet e shfrytëzimit me rezervuar);
8. Projekti i dekantuesit dhe shkarkimit të ujit në trupin ujor, kanalit të dërgimit, basenit të presionit dhe tubacionit me presion;
9. Projekti godinës së centralit dhe shkarkimit të ujit në trupin ujor pritës.
10. Plan biznesi;
11. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
12. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, të kryera në laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.
13. Projekti dhe specifikimet e stacionit hidrometrik, që duhet të ndërtohet, të paktën poshtë veprës së marrjes.

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 7

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE TEKNOLOGJIKE

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s)_____

Mënyra e Kaptazhit (Specifiko) _____

Kapaciteti i depove, [nëse ka (m^3)]_____

Volumi vjetor (m^3) _____

Prurja llogaritëse (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja mesatare e muajit më të thatë l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja ekologjike (l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Qëllimi i përdorimit të ujit:

Proces teknologjik ☐

Proces ftohjeje ☐

Ndërtim objektesh ☐

Ndërtim rrugësh ☐

Lavazh ☐

Tjetër ☐ Specifiko_____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

Periudha e përdorimit të ujit:

Shumëvjeçare ☐

Vjetore ☐ Nga muaji _____deri në muajin _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Projekti i veprës së marrjes së ujit;
3. Projekti i skemës së përdorimit dhe qarkullimit të ujit;
4. Projekti i trajtimit dhe shkarkimit të ujit në trupin ujor pritës;
5. Studimi hidrologjik;
6. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të

shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

7. Analiza të mostrave të marra në trupin ujor sipërfaqësor, të kryera në laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

KËRKUESI: _____

(firma)

FORMULARI 8

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR PËR LUNDRUESHMËRI

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____
Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor që do të pëdoret:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Itinerari i rrugës që përshkohet _____

Pika e fillimit të itinerarit (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Pika e përfundimit të itinerarit (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Numri i rrugëve që do të kryhen: _____

Periudha e përdorimit të ujit:

Shumëvjeçare ☐

Vjetore ☐ Nga muaji _____deri në muajin _____

II. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Raport mbi përshkrimin e mjeteve që do të përdoren;
2. Skema e qarkullimit të mjeteve;
3. Vërtetim nga Autoritetet Detare (vetëm për mjetet që lundrojnë në det).

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 9

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIMIN E UJËRAVE DETARE PËR PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE

I. MARRJA E UJIT

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Mënyra e matjes së sasisë së ujit që do të përdoret:

Me matës automatik ☐

Tjetër ☐ Specifiko _____

Periudha e përdorimit të ujit:

Shumëvjeçare ☐

Vjetore ☐ Nga muaji _____deri në muajin _____

II. SHKARKIMI.

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Trupi ujor pritës (specifiko llojin dhe emrin) _____

Prurja që shkarkohet (l/s) _____

Volumi që shkarkohet (m^3/ditë) _____

Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotur (zgjidh një opsion):

Primar ☐ Sekondar ☐ Terciar ☐

III. DOKUMENTACIONI TEKNIK.

1. Dokumente të pronësisë së tokës (autorizimin/marrëveshjen paraprake për përdorimin e saj nga pronarët/subjektet, nëse veprimtaria shtrihet në prona të pronarëve, apo subjekteve të tjerë);
2. Projekti i parametrave të valës në frontin e vendosjes së turbinave;
3. Projekti i vendosjes së turbinave;
4. Modelimi i efektit të projektit në dinamikën e vijës bregdetare të zonës që ndikohet;
5. Plan biznesi;
6. Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) paraprak, ose deklarata e ministrit për VNM-në e thelluar, të shoqëruar me raportin paraprak ose të thelluar të VNM-së, në rastet kur për instalimin është kryer procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimit në ligjin "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

KËRKUESI: _____
(firma)

FORMULARI 10

KËRKESË PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME TË TJERA

(që nuk përfshihen në formularët e tjerë)

I. MARRJA E UJIT.

Emri i burimit ujor_____

Vendndodhja e burimit ujor (Koordinatat KRGJSH):

X _____ Y _____ Z _____

Lloji i burimit ujor nga do të merret uji:

Det ☐

Lumë ☐

Liqen ☐

Rezervuar ☐

Përrua ☐

Kanal ☐

Të tjera ☐ Specifiko _____

Prurja e ujit të kërkuar (l/s)_____

Mënyra e Kaptazhit (Specifiko) _____

Kapaciteti i depove, [nëse ka (m^3)]_____

Volumi vjetor (m^3) _____

Prurja llogaritëse (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Prurja mesatare vjetore (l/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja mesatare e muajit më të thatë (m^3/s) (ku është e aplikueshme)_____

Prurja ekologjike e propozuar (l/s) (ku është e aplikueshme) _____

Qëllimi i përdorimit të ujit:

Qëllime sanitare ☐

Pishinë ☐

Strategjia, në pjesën e parë, analizon gjendjen e mjedisit dhe SHÇBA-së, të lidhur ngushtë me atë të strukturave shtetërore që përfshihen në objektin e veprimtarisë së Shërbimit, si dhe faktorët kryesorë që kanë impakt në eficiencën e punës së këtij Shërbimi, duke arritur edhe në përfundime e rekomandime përkatëse. Në pjesën e dytë projektohet kuadri strategjik për zhvillim, me vizionin për të ardhmen, parimet e veprimtarisë, prioritetet dhe politikat e zhvillimit, të cilat plotësohen me burimet financiare që do të duhen; mënyrën e zbatimit dhe sistemin e monitorimit e vlerësimit.

Strategjisë i bashkëngjitet Plani i Veprimit, i cili përmban për çdo prioritet e objektiv, detyrat dhe masat që do të merren, me koston, strukturën përgjegjëse dhe kohën e realizimit.

Fokusi i këtij dokumenti janë politikat e zhvillimit të SHÇBA-së, për të përafruar standardet e këtij Shërbimi me ato të vendeve perëndimore dhe eficiencën e tij, në luftën kundër korrupsionit në strukturat që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit.

Dokumenti strategjik është i domosdoshëm për strukturat vendimmarrëse, për të planifikuar, për të udhëhequr e për të realizuar politikat e duhura në zhvillimin institucional të Shërbimit; drejtuesve të këtij Shërbimi për zhvillimin e standardeve të Shërbimit dhe rritjen e eficiencës në kryerjen e detyrave; strukturave ligjzbatuese që përfshihen në objektin e veprimtarisë së këtij Shërbimi; gjithë punonjësve të Shërbimit, për t'u organizuar në kryerjen e detyrave; aktorëve të tjerë shtetërorë e shoqërorë që krijojnë marrëdhënie me veprimtarinë e Shërbimit, si dhe opinionit publik, i cili është shumë i interesuar.

Lidhja me dokumentet e tjera strategjike

Strategjia e zhvillimit të SHÇBA-së është e lidhur ngushtësisht me programe dhe strategji të tjera shtetërore, të cilat trajtojnë reformat institucionale, si dhe drejtime apo probleme me rëndësi për veprimtarinë shtetërore e shoqërore. Ndër to evidentojmë strategjitë kombëtare për zhvillim dhe integrim[8], për sigurinë kombëtare[9], Reformën në Administratën Publike[10], Strategjinë e Rendit Publik[11], në Sistemin e Drejtësisë[12], kundër Korrupsionit[13], Krimit të Organizuar[14] etj.

Dokumenti merr në konsideratë vizionin, objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në këto strategji nga strukturat e larta shtetërore për zhvillimin e reformave institucionale dhe luftën kudër korrupsionit e krimit të organizuar; raportin e vetëvlerësimit të brendshëm të SHÇBA-së[15], vlerësimin dhe rekomandimet e bëra nga PAMECA dhe ICITAP[16], studimin për korrupsionin në Policinë e Shtetit[17] dhe në përshtatje me misionin e përgjegjësitë e ngarkuara nga ligji e faktorët e tjerë, përcakton prioritetet, objektivat dhe masat që do të merren për zhvillimin e tij.

I.2 Metodologjia

Për t'i paraprirë hartimit të këtij dokumenti, u përgatit raporti i vlerësimit të brendshëm (vetëvlerësimi), si dhe vlerësimi i jashtëm , i përgatitur nga ekspertët ndërkombëtarë të atashuar pranë programit ICITAP dhe Misionit Policor Evropian PAMECA. Këto dokumente ishin një risi në historinë e zhvillimit të Shërbimit. Mbi bazën e termave të referencës të miratuar dhe të metodologjisë shkencore u vlerësuan elementet

[8] Strategjia kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, VKM nr. 348/2016.

[9] Strategjia e Sigurisë Kombëtare, ligji nr. 103/2014.

[10] Strategjia për Reformën në Administratën Publike, VKM nr. 319/2015, të ndryshuar.

[11] Strategjia e Rendit Publik, VKM nr. 702/2015.

[12] Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë.

[13] Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, për periudhën 2015–2020, VKM nr. 247/2015.

[14] Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020, dhe planit të veprimit 2013–2016, VKM nr. 663/2013.

[15] Raporti i vetëvlerësimit të brendshëm të SHÇBA-së, 2018.

[16] Raporti për gjetjet dhe rekomandimet i PAMECA-s dhe i ICITAP-it, mars 2019.

[17] Studimi i IDN-së mbi korrupsionin në polici, 2015.

kryesore institucionale të Shërbimit, si dhe kënaqësia e opinionit publik për Shërbimin.

Qëllimi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Shërbimit, ishte për të njohur realisht gjendjen e vetë organizatës së lidhur me efektshmërinë e Shërbimit, për mbrojtjen e ligjit dhe të të drejtave të qytetarëve; kënaqësinë dhe vlerësimin e komunitetit; faktorët dhe shkaqet që ndikojnë, si dhe për të projektuar politikat, alternativat e masat që duhet të marrë Shërbimi për të ndryshuar standardet në raport me pritshmërinë e Shërbimit.

Në funksion të vlerësimit u zhvilluan analiza të veçanta për elemente të rëndësishme të funksionimit të institucionit, si: legjislacionin, organizimin, personelin, arsimin profesional, gjendjen e burimeve materiale, mjetet financiare; u shfrytëzuan raporte dhe statistika mbi shkeljet e ligjshmërisë në pesë vjetët e fundit; fenomenet që shqetësojnë strukturat objekt i veprimtarisë së Shërbimit, si dhe u sigurua konsulenca e partnerëve ndërkombëtarë, si: PAMECA V, ICITAP dhe OSBE. Studimi mbi vlerësimin e Shërbimit analizon dhe pasqyron gjendjen e Shërbimit, fenomenet, treguesit kryesorë, si dhe elementet më esenciale të zhvillimit të Shërbimit dhe njëherësh arrin në konkluzione për aktorët e faktorët ndikues dhe jep mendime e rekomandime për zhvillimin në të ardhmen.

U analizua infrastruktura ligjore për organizimin dhe funksionimin e SHÇBA-së dhe strukturave të tjera të Ministrisë së Brendshme; ndryshimet Kushtetuese, legjislacioni për reformën në sistemin e drejtësisë, vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera të Ministrisë së Brendshme[18]; konventat ndërkombëtare kundër Korrupsionit[19]; Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e KE-së për anëtarësimin e Shqipërisë në BE[20]; strategjitë kombëtare për zhvillim e integrim etj.

Strategjia e SHÇBA-së, krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore dhe Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe për përcaktimin e prioriteteve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, merr në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e bëra në raportet e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm, si dhe anketimet e realizuara nga shoqatat joqeveritare mbi korrupsionin në polici.

KAPITULLI I
VLERËSIM I MJEDISIT DHE I GJENDJES SË SHÇBA-së

I.1 Mjedisi ku zhvillon veprimtarinë SHÇBA

Mjedisi, në kuptimin e përgjithshëm për SHÇBA-në, përfshin të gjithë strukturat shtetërore e institucionet publike; sistemin e drejtësisë; organizmat shoqërorë, sipërmarrjen e lirë, opinionin publik, me të cilët e lidh veprimtaria e përditshme. Strukturat e PSH-së dhe strukturat e tjera që përfshihen në objektin e veprimtarisë së SHÇBA-së, së bashku me komunitetin të cilit i shërbejnë, përbëjnë mjedisin direkt ku operon Shërbimi.

Njohja në detaje e këtij mjedisi me të gjitha elementet përbërëse ligjore, organizative, procedurale dhe deri te cilësia e Shërbimit të afruar, përbën një domosdoshmëri për Shërbimin, i cili duhet të punojë në mënyrë të vazhdueshme e me përkushtim.

Policia e Shtetit, sipas përcaktimit të ligjit është "institucion i administratës shtetërore", në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i organizuar sipas ndarjes administrative të pushtetit, që funksionon në mënyrë të centralizuar, sipas parimeve të policimit demokratik dhe që ka pavarësi në mbikëqyrjen e ligjit dhe luftën kundër krimit.[21]

Standardet e kësaj organizate në dhjetëvjeçarin e fundit janë rritur dhe përafruar me ato të vendeve perëndimore, çka duket në rolin e saj për zbatimin e ligjit, luftën kundër krimit dhe garantimin e sigurisë publike e asaj të qytetarëve.

[18] Ligji nr. 12/2018. "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, SHÇBA-së", i ndryshuar.

[19] Ligji nr. 8778, datë 26.4.2011, "Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin", i ndryshuar.

[20] Ligji nr. 9590/2006, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tjera anëtare".

[21] Ligji nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.

Garda e Republikës është njësi për sigurimin e personaliteteve dhe të objekteve të rëndësishme shtetërore, që funksionon sipas ligjit të veçantë. Me gjithë ndryshimet e bëra, ligji është i modelit militar, ndaj është e nevojshme që edhe ky organ t'i nënshtrohet reformimit e shndërrohet në një shërbim publik, i cili në kryerjen e detyrave bashkëpunon me qytetarët dhe subjekte të tjera të sigurisë e mjedisit shoqëror.[22]

Shërbimi i mbrojtjes, parandalimit dhe shpëtimit nga zjarri rregullohet me ligj të veçantë dhe funksionon nën varësinë e strukturave të qeverisjes vendore (bashkive). Ai përmbush shërbime për mbrojtjen e individit, pronës dhe komunitetit, duke ushtruar kompetenca në fushën administrative[23].

Nga analizat e bëra prej strukturave shtetërore, organizmave ndërkombëtarë, por dhe vetë strukturat e mësipërme, konkludohet, se: "Korrupsioni është sëmundja më e përhapur që pengon zhvillimin institucional dhe treguesit e Shërbimit ndaj qytetarëve. Për rrjedhojë, lufta kundër tij, përbën një kusht jo vetëm për ndryshimin e standardeve të shërbimeve, por dhe për anëtarësimin e vendit në BE".

Duke vështruar kuadrin institucional shqiptar në fushën e antikorrupsionit, rezulton se ai është i shpërndarë në disa organe e struktura (copëzuar); pra nuk ka një organ të unifikuar të specializuar dhe të pavarur. Përgjegjësia për të luftuar korrupsionin është shpërndarë në disa organe e struktura, në varësi të qeverisjes, ku përfshihet edhe SHÇBA-ja në MB; institucione publike kushtetuese të pavarura, si ILDKPKI-ja e KLSH-ja dhe strukturat e drejtësisë.

Korrupsioni në strukturat, që janë objekt i veprimtarisë së SHÇBA-së dhe veçanërisht në PSH, zhvillohet kryesisht në strukturat që shërbejnë për promovimin e burimeve njerëzore; sigurimin e bazës materiale e të teknikës së Shërbimit; e informacionit që administrohet; prokurimet e fondeve; dhënien e lejeve, autorizimeve të përcaktuara nga legjislacioni etj.

Rrezikshmëria e korrupsionit është për të gjitha nivelet dhe rolet e punonjësve të Policisë, por veçanërisht kjo është me pasoja të rënda kur zhvillohet nga komandues e drejtues të strukturave që bëhen pre e ndikimit politik, atij shoqëror dhe kriminal, për të bërë lëshime e favorizime; apo edhe për të bashkëpunuar me autorët e krimeve dhe krimin e organizuar.

Gjendja e korrupsionit në sistemin e strukturave shtetërore e atyre të drejtësisë, e në veçanti në strukturat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit e të luftës kundër krimit, që kanë detyrë të zbulojnë e të godasin këtë dukuri, na shtyn të mendojmë se problemi duhet vlerësuar duke marrë masa të gjithanshme institucionale e operacionale.

Për t'iu kundërpërgjigjur gjendjes së korrupsionit në Polici e strukturat e tjera, duhet së pari të përforcohen standardet institucionale të këtyre strukturave dhe integriteti në veprimtarinë e tyre, dhe së dyti duhen zhvilluar standardet e SHÇBA-së me të gjitha elementet përbërëse e burimet e duhura për kryerjen e detyrave.

Për këtë, kujtojmë thirrjen e GRECO-s, i cili rekomandon: "Të gjitha strukturat kundër korrupsionit të jenë plotësisht të pavarura, të afta, të kenë burime të mjaftueshme dhe të marrin mbështetje dhe bashkëpunim të plotë nga të gjitha strukturat e qeverisë dhe të zbatimit të ligjit për të kryer rolin e tyre".

I.2 Infrastruktura ligjore dhe organizimi

SHÇBA-ja është e organizuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit organik "Për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme", si dhe të paketës me akte nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tij.

Ligji përcakton qartë qëllimin, misionin, statusin dhe objektin e veprimtarisë së Shërbimit; parimet bazë të organizimit e të veprimtarisë; organizimin nga niveli qendror e deri në atë vendor dhe autoritetet drejtuese; detyrimet dhe të drejtat e personelit; kompetencat për kryerjen e detyrave, si dhe çështjet e tjera që lidhen me trajtimin e punonjësve, disiplinën etj.

Misioni i këtij Shërbimi është: "Garantimi i zbatimit të ligjit, mbrojtja e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të të drejtave të shtetasve nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada".

SHÇBA-ja e zhvillon veprimtarinë në strukturat e PSH-së, GR-së dhe SHMZSH-së. Përgjegjësitë institucionale të këtij Shërbimi, që përbëjnë dhe objektin e punës, janë:

[22] Ligji nr. 8869/2003, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

[23] Ligji nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin".

a) ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;

b) parandalimi i shkeljeve të ligjit dhe të veprave penale;

c) zbulimi dhe hetimi i veprave penale, të kryera nga punonjës të strukturave gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj.

Parimet bazë të organizimit të veprimtarisë së Shërbimit janë: ligjshmëria; pavarësia nga strukturat ndaj të cilave ushtron veprimtarinë; paanshmëria; respektimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut; respektimi i dinjitetit dhe i integritetit fizik; transparenca; proporcionaliteti; ruajtja e informacionit të klasifikuar; kontrolli dhe llogaridhënia.[24]

Për realizimin e misionit e të përgjegjësive, ligji ka dhënë një sërë kompetencash për të trajtuar ankesat e bëra; për të inspektuar strukturat; për të hetuar shkeljet ligjore dhe veprat penale të kryera etj., duke ushtruar funksionet dhe autoritetin e Policisë Gjyqësore, si dhe duke përdorur një sërë mjetesh ligjore gjatë kryerjes së detyrave.

Në zbërthim të legjislacionit, shërbimi ka miratuar një paketë të kompletuar me akte normative, ku përfshihen rregullorja e brendshme dhe një sërë udhëzimesh e urdhrash të tjerë për mirëfunksionimin e shërbimit.[25]

a) Krahasuar me legjislacionin që rregullon këtë shërbim, objektin dhe parimet e veprimtarisë me standardet e partnerëve evropianë kundër korrupsionit (EPAC)[26] apo dhe me shërbimet homologe të vendeve perëndimore, rezulton se ai është modeluar e përafruar sipas eksperiencës së vendeve perëndimore dhe pas vitit 2014 është përfshirë në proces reformimi për t'u shndërruar në një Njësi të Mbikëqyrjes Policore, që siguron përgjegjshmërinë policore në Shqipëri.

b) Legjislacioni aktual duhet ndryshuar e plotësuar, për të:

- qartësuar statusin e Shërbimit, i cili cilësohet si: "person juridik publik, strukturë e veçantë e MB-së, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit", çka e minimizon rolin e tij në raport me përgjegjësitë dhe kompetencat që ushtron. Referuar përgjegjësive, parimeve e kompetencave që ushtron dhe rolit që luan për mbikëqyrjen e veprimtarisë policore, statusi duhet cilësuar: "është organ i administratës shtetërore";

- zgjeruar objektin e veprimtarisë së Shërbimit, duke përfshirë përveç tri strukturave që janë aktualisht (PSH, strukturat e sigurimit të personaliteteve dhe të SHMZSH-së), (neni 5), edhe struktura të tjera që janë nën varësinë e MB-së, të cilat administrojnë burime të shumta financiare e materiale dhe ushtrojnë kompetenca vendimmarrëse për trajtimin e tyre;

- saktësuar raportet e drejtuesit të SHÇBA-së me autoritetin politik (ministrin e Brendshëm), si "autoriteti më i lartë" dhe po kështu me autoritetet drejtuese të Policisë e strukturave të tjera, çka ndikon në marrëdhëniet e përditshme të punës dhe ezaurimin e problemeve që evidentohen (neni 13);

- përcaktuar qëndrueshmërinë në ligj ose jo të dispozitave ligjore që i japin tagra të veçanta Shërbimit, por që në praktikën pesëvjeçare nuk janë zbatuar, siç janë ata për ushtrimin e "paralajmërimit" dhe "testin e integritetit" (nenet 42 dhe 58);

- harmonizuar dispozitat e ligjit të SHÇBA-së me ligje të tjera, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij (rregullore, urdhra e udhëzime). Më konkretisht:

- ligjin "Për policinë e shtetit" dhe rregulloren e brendshme të këtij organi, sepse ka mospërputhje midis dy ligjeve për ndarjen e përgjegjësive midis SHÇBA-së dhe DSP-së për trajtimin e shkeljeve disiplinore e administrative, si dhe për probleme të tjera (rregullimin e gradave; kalimin e specialistëve nga njëri organ në tjetrin etj.);

- ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"[27] dhe atë "Për nëpunësin civil", ku disa prej dispozitave të këtyre ligjeve nuk zbatohen, sidomos për respektimin e parimeve dhe kritereve në trajtimin e punonjësve që janë me statusin e nëpunësit civil etj.[28];

- aktet e brendshme, si: rregullorja e Shërbimit, urdhrat e udhëzimet e ndryshme, tek të cilat gjenden norma të paharmonizuara me dispozitat e ligjit, aktet e tjera ligjore, por dhe midis tyre, (rregullore e Shërbimit);

- ligjin nr. 10 142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të

[24] Paketa ligjore, rregullore e Shërbimit.

[25] Paketa ligjore, rregullore e Shërbimit.

[26] Standardet evropiane kundër korupsionit (EPAC).

[27] Ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

[28] Ligji 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", me qëllim njohjen e statusit për të gjithë punonjësit e SHÇBA-së, pavarësisht nëse janë me gradë apo civil. Kjo do të garantonte një trajtim të barabartë me strukturat që mbikëqyr SHÇBA-ja dhe do të motivonte punonjësit e Shërbimit.

Organizimi i SHÇBA-së është në nivelin e një drejtorie të përgjithshme në Ministri, i formatuar me struktura të tjera në nivelin e drejtorive e sektorëve, sipas problemeve e detyrave që ndjekin, ndërsa në nivelin vendor, organizimi është sipas ndarjes administrative të strukturave policore.

Modeli i organizimit të SHÇBA-së është tipik i formës piramidale, i ndërtuar sipas parimit të centralizimit që funksionon në mënyrë të centralizuar nga qendra në nivelin vendor dhe anasjelltas, duke ndjekur problemet e shfaqura në strukturat e Policisë e strukturat e tjera, sipas autorizimit të dhënë nga ligji.

Struktura organizative dhe drejtuesi i Shërbimit, pas vitit 2014, janë ndryshuar disa herë, duke u dhënë prioritet herë drejtimit dhe herë operimit në bazë; gjë që ka ndikuar në funksionimin e strukturave, besimin e punonjësve dhe treguesit e punës së Shërbimit.

Aktet normative të brendshme (rregulloret, udhëzimet dhe urdhrat), së bashku me përshkrimet e punës për çdo funksion organik; procedurat standardet e punës, sistemi i trajtimit e promovimit të punonjësve, kanë nevojë të ripunohen, harmonizohen dhe unifikohen, për t'u shërbyer më mirë strukturave e punonjësve.

Vlerësuar në tërësi, infrastruktura ligjore e organizative për shërbimin përbën një paketë të plotë që rregullon funksionimin normal, sipas parimeve e standardeve demokratike, por gjetjet e mësipërme dhe objektivi për të zhvilluar më tej standardet e Shërbimit, shtrojnë nevojën e bërjes së ndryshimeve e plotësimeve, si në legjislacion ashtu edhe në organizim.

I.3 Burimet njerëzore dhe kualifikimi

Personeli i SHÇBA-së ndahet në dy kategori, ku përfshihen:

a) personeli pa grada, i cili përbën jo më pak se gjysmën e personelit të Shërbimit;

b) personeli operacional, që kryen veprimtari informativo-gjurmuese dhe mban gradë.

Personeli i Shërbimit, me përjashtim të punonjësve të shërbimeve mbështetëse, gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe më ligjin nr. 25/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore".

- Në nivel qendror, janë të dislokuar rreth 62% e organikës së personelit, ndërsa në nivel vendor, janë 39% e totalit. Referuar përgjegjësive dhe kompetencave që ushtrojnë strukturat, rezulton se për veprimtarinë e zbulimit e të hetimit të krimit, operojnë 52% e limitit organik, ndërsa për trajtimin e ankesave dhe për hetimin administrativ shërbejnë 48% e numrit të përgjithshëm.[29]

- Numri i punonjësve të këtij Shërbimi, në raport me limitin organik në strukturat e PSH-së, GR-së dhe SHMZSH-së është afërsisht 1/100. Zgjerimi i objektit të punës dhe i përgjegjësive, shtimi i ankesave dhe i çështjeve për ndjekje, si dhe infrastruktura e dobët në përdorim diktojnë nevojën e shtimit të personelit të këtij Shërbimi.

- Formimi kulturor e profesional i punonjësve është i ndryshëm, sa për shkak të arsimit të mëparshëm dhe strukturave ku kanë punuar, aq dhe për statusin aktual që mbajnë. Për kualifikimin dhe specializimin e vazhdueshëm të punonjësve, nuk ka pasur vëmendje dhe program të veçantë, përjashto trajnimet e bëra nga partnerët ndërkombëtare (PAMECA, ICITAP, OSBE etj.).[30]

Arsimi i ndryshëm dhe i hershëm i shumicës së punonjësve (rreth 80%), paqëndrueshmëria e personelit për shkak të lëvizjeve të shpeshta dhe nënvleftësimi i kualifikimit të vazhdueshëm, ka ndikuar në nivelin profesional dhe performancën e Shërbimit, veçanërisht në procesin e hetimit e të dokumentimit të veprave penale të korrupsionit.

- Treguesit e mësipërm shtrojnë nevojën e përmirësimit të punës me burimet njerëzore në të gjitha elementet, për të administruar sipas standardeve të reja dhe për të përmirësuar raportin midis strukturave drejtuese e atyre të operimit, strukturave që merren me veprimtari administrative dhe të atyre që kryejnë hetimin e veprave penale; për të ndryshuar sistemin e vlerësimit të aftësive profesionale; kualifikimit të vazhdueshëm;

[29] Raporti i vlerësimit të brendshëm.
[30] Raporti i vlerësimit të jashtëm.

vlerësimit të performancës dhe promovimit në detyrë.

I.4 Kushtet e punës, teknologjia dhe trajtimi

- Kushtet e punës të SHÇBA-së, me përjashtim të Drejtorisë së Përgjithshme, që aktualisht janë brenda Ministrisë, nuk i plotësojnë standardet për veprimtari normale dhe veç kësaj ato ndodhen brenda strukturave të PSH-së apo strukturave të tjera që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit. Duke punuar për pranimin dhe për zgjidhjen e ankesave, pranë zyrave të pritjes së qytetarëve nga shërbimi policor, shtetasit vënë nën dyshim besueshmërinë dhe objektivitetin e zgjidhjes së ankesës.

- Teknologjia e dobët e informacionit për të regjistruar dhe për të analizuar ankesat, si dhe ajo e menaxhimit të çështjes, ul performancën dhe vështirëson drejtimin për qarkullimin e informacionit, komunikimin, marrjen e vendimeve, dhënien e detyrave dhe ndjekjen e realizimit të tyre. Mungesa e investimeve në *software* të TI-së dhe në teknologji për databazat, si dhe e kapaciteteve për të gjeneruar statistika të detajuara e analizuar të dhënat e databazave, ka ndikuar si në njohjen e parandalimin e shkeljeve e abuzimeve, ashtu dhe në dokumentimin e goditjen e autorëve të veprave penale.

- Sistemi i shpërblimit të punës (pagesës) nuk u përgjigjet plotësisht detyrave që ushtrojnë punonjësit dhe produktit që ata realizojnë, për arsye të statusit dhe kritereve të diferencuara që përdoren për punonjësit me status civil dhe për ata me gradë. Trajtimi i diferencuar ndikon negativisht te punonjësit, çka shtron nevojën e rivlerësimit të kritereve e sistemit të pagesës, në mënyrë që ai të jetë motivues.

I.5 Parandalimi i shkeljeve ligjore, krimit dhe korrupsionit

Referuar përgjegjësive, detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në ligj, si dhe objektivave të planifikuar në programet e punës, performanca e veprimtarisë së SHÇBA-së rezulton të jetë përmirësuar nga viti në vit.

Shërbimi vazhdon të përballojë një volum të madh pune, i cili shprehet në:

a) mbledhjen e administrimin e informacionit që lidhet me objektin e punës së SHÇBA-së;

b) trajtimin e ankesave të qytetarëve për policimin, sigurinë publike dhe punonjësit;

c) inspektimin e strukturave për shkeljet e ligjshmërisë;

d) verifikimin e pastërtisë për personat që i nënshtrohen vetingut;

e) hetimin e shkeljeve të ligjit, veprave penale të ndryshme dhe korrupsionit.

Në volumin e punës, peshën më të madhe e zë veprimtaria administrative procedurale për të trajtuar informacionet, ankesat dhe praktikat që lidhen me ushtrimin e detyrave e të kompetencave në veprimtarinë e përditshme, si dhe ato për integritetin e punonjësve.

Treguesit kryesorë të veprimtarisë së SHÇBA-së, për vitet 2017–2019 (tab. 1)

Nr.	Veprimtaria	Periudha		
	Llojet e veprimtarisë	2017	2018	2019
1	Informacione	1394	1034	752
2	Ankesa	1048	1978	1731
3	Inspektime	53	34	75
4	Vetingu	-	4574	3927
5	Vepra penale	200	201	250

Referuar viteve të fundit, 2017–2019, sipas drejtimeve të veprimtarisë, peshën më të madhe e zë trajtimi i informacioneve, ankesave dhe praktikave për pastërtinë e figurës të subjekteve që i nënshtrohen vetingut.

Vlerësuar veçmas, drejtimet e veprimtarisë, rezulton se informacioni për veprat penale në radhët e punonjësve të strukturave nga burime të kualifikuara është i ulët, jocilësor për problemin që shqetëson (korrupsionin) dhe me tendencë në ulje. Ankesat e qytetarëve kanë tendencë rritjeje dhe janë kryesisht, për: "mosveprim" rreth 50%; për "shkelje të procedurave standarde të punës", 30%; dhe për "veprime arbitrare", "gjobë të padrejtë" e "shkelje të normave të etikës" rreth 20%.

Nga informacionet, ankesat dhe inspektimet e bëra në organe e struktura të veçanta janë bërë rekomandime për masa disiplinore strukturave

përgjegjëse; për fillim të procedimit penal në Prokurori, si dhe janë çelur procedime për hetime të mëtejshme. Për hetimin administrativ të ankesave e informacioneve të ndryshme tashme ka një eksperiencë të mirë që duhet pasuruar më tej, por duhet treguar vëmendje edhe për rivendosjen e së drejtës dhe për kompensimin e të dëmtuarit.

- Kjo ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të të dëmtuarve nga veprimet e paligjshme, të cilët duhen kompensuar moralisht e ekonomikisht; e po kështu duhet edhe për punonjësit e strukturave të dyshuara, të cilët rezultojnë në rregull me ligjin e për pasojë u duhen rivendosur të drejtat e nëpërkëmbura padrejtësisht. Transparenca mbi vendimet e marra brenda dhe jashtë strukturave ku shërbejnë punonjësit, do t'i shërbejë shumë vendosjes së të drejtave dhe besimit në radhët e punonjësve e qytetarëve.

- Për kryerjen e detyrimeve ligjore në verifikimin e pastërtisë së subjekteve që i nënshtrohen vetingut, volumi i punës është përballuar me sukses edhe pse ai është në rritje. Megjithatë duhet mbajtur në konsideratë që veprimtaria e Shërbimit në këtë drejtim duhet të formalizohet, duke ngritur strukturë të veçantë dhe duke caktuar rregulla standarde për gjithë procesin, përfshirë dhe rekomandimin, për të evituar çdo qëndrim subjektiv dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

- Vëllimi i veprave penale të ndjekura nga SHÇBA-ja dhe i subjekteve të dyshuara për përfshirje në krim gjatë vitit 2018, rezulton të jetë në të njëjtët parametra me vitin e mëparshëm. Gjatë kësaj periudhe i janë përcjellë prokurorisë 250 referime për vepra penale për 474 persona, nga të cilët rreth 88% janë punonjës të Policisë së Shtetit; ku rreth 20% janë punonjës të nivelit të parë drejtues. Format më të përhapura të veprave kriminale që janë referuar për ndjekje penale në Prokurori, janë veprat korruptive të shpërdorimit të detyrës, të cilat zënë rreth 50% të shumës; ato në drejtim të bimëve e lëndëve narkotike që arrijnë në 17% dhe të tjerat për vepra të ndryshme penale.

- Në numrin e punonjësve të dyshuar për kryerje të veprave penale, peshën më të madhe, rreth 88%, e zënë punonjësit e PSH-së; ndër të cilët rreth 20% janë punonjës të nivelit të parë drejtues. Kjo vjen për shkak të limitit të madh organik që ka ky organ dhe dinamikës së ngjeshur të shërbimeve që kryen në veprimtarinë e përditshme për mbrojtjen e ligjit dhe parandalimin e zbulimin e krimit.

- Diferenca midis numrit të procedimeve të hapura apo çështjeve të referuara për ndjekje penale dhe atyre të dërguara në gjykatë është e madhe; çka provon se çështjet e filluara nuk kanë pasur besueshmëri ligjore dhe janë shkelur të drejtat e punonjësve; aftësia për të hetuar e dokumentuar është tepër e ulët ose mungon vullneti dhe është bërë kompromis me mosveprim për të fshehur krimin.

- Treguesit e evidentuar për zbulimin dhe hetimin e krimit flasin për punë minimale të Shërbimit në tërësi e në veçanti të strukturave përgjegjëse; ngarkesë të ulët në punë të punonjësve; dobësi profesionale dhe drejtuese dhe pse jo edhe ambientim me gjendjen dhe mungesë vullneti për goditjen e korrupsionit.

Këto gjetje e të tjera, diktojnë nevojën e marrjes së masave komplekse për të ndryshuar gjendjen, duke forcuar integritetin dhe kualifikimin e personelit; teknikën në përdorim, si dhe metodën e drejtimit për të përdorur në hetim mjetet e reja ligjore dhe metodat shkencore.

I.6 Marrëdhëniet me publikun dhe perceptimi i qytetarëve

SHÇBA-ja vlerëson marrëdhëniet me opinionin publik dhe është munduar t'i forcojë ato duke përdorur forma më të përshtatshme për komunikim e informim me transparencë.

- Tashmë është krijuar traditë e mirë për funksionimin e zyrës së ankesave në hyrjen e MB-së, si dhe në zyrat pranë strukturave vendore të policisë, ku qytetarët drejtohen për ankesat e problemet që kanë.

- Veç kësaj funksionon rregullisht komunikimi me qytetarët, të cilët kanë mundësinë të shprehin lirshëm ankesat dhe shqetësimet për shërbimet e sigurisë, nëpërmjet linjës telefonike të dedikuar për ankesat ndaj punonjësve të PSH-së (0800 90 90), si dhe *email*-it të dedikuar: ankesa@shcba.gov.al.

- Për të njohur opinionin e gjerë publik me ngjarjet e ndodhura, rolin dhe përgjegjësinë e punonjësve të zbatimit të ligjit, nëpërmjet medies së shkruar e asaj televizive është dhënë informacioni i duhur me transparencë. Po kështu, për të njohur qytetarët dhe grupe të ndryshme shoqërore me të drejtat e tyre, për të ndërgjegjësuar ata dhe për të rritur besueshmërinë ndaj Shërbimit, janë organizuar informime e diskutime në shkolla e

mjedise të tjera, si dhe janë shpërndarë fletëpalosje të përgatitura për këtë qëllim.

Perceptimi i opinionit publik

- Për vlerësimin e Shërbimit nga opinioni publik, nuk është ndërmarrë ndonjë studim e anketim i veçantë deri me sot e, veç kësaj, ligji nuk përcakton asnjë detyrim për të matur performancën në këtë mënyrë.[31]

- Në anketimin e bërë nga IDRA-ja, për policimin në komunitet, qytetarët shprehen të pakënaqur për situatën në ambientin ku jetojnë, lidhur me ndotjen e mjedisit, zhurmat, cenimin e pronës, prishjen e rendit publik, sigurinë rrugore, shpërndarjen e lëndëve narkotike, mosrespektimin e kërkesave ligjore e morale të bashkëjetesës në bashkëpronësi: rreth 66% e punonjësve të policisë shprehen, se: "zhvillimi i karrierës, dhënia e gradave, transferimet, nuk kanë qenë të motivuara e transparente" dhe, për rrjedhojë, kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e organizatës dhe efektivitetin e punës dhe rreth 53% e tyre ndihen pak të përkrahur nga komuniteti gjatë një ndërhyrjeje në rrugë apo në lagje etj.[32]

- Sondazhi i IDN-së, për sa u përket eksperiencave personale me korrupsionin në radhët e policisë, evidentoi se 32% e të anketuarve kishin pasur kontakte me oficerë policie gjatë vitit të fundit; 18% deklaruan se u ishte kërkuar nga policia rrugore të paguanin ryshfet dhe 17% pranuan se i kishin ofruar ryshfet oficerëve të policisë rrugore.[33]

- Nga anketimi i bërë mbi "Perceptimin e qytetarëve për sigurinë dhe policinë", prej SCPA-ja, rezulton, se: 63 % e të anketuarve shprehen, se: "Policia ka bërë një punë të mirë për sigurinë"; ndërsa për sigurinë në lagje, 75% e të anketuarve janë shprehur, se: "Ndihen të sigurt kur shikojnë prezencën e policisë".[34]

- Vlerësimi i opinionit publik dhe i organizmave ndërkombëtarë të besueshëm për korrupsionin në këto organe është në disproporcion me treguesit e ndëshkimit nga SHÇBA-ja dhe vetë strukturat, të cilët janë kryesisht me masa disiplinore e administrative dhe shumë pak me dënime penale (këto janë vetëm për punonjës të nivelit zbatues e të mesëm).

- Për sa më lart, mendojmë se pavarësisht nga shifrat që jepen, efektiviteti i SHÇBA-së dhe i vetë strukturave që mbikëqyren (PSH, GR, SHMZSH), për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin veprave korruptive në radhët e tyre, është i ulët dhe nuk i përgjigjet gjendjes reale të kësaj dukurie me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

I.7 Disa konkluzione mbi SHÇBA-në

Nga analiza dhe vlerësimi i gjendjes së brendshme të SHÇBA-së, si dhe i mjedisit ku ai zhvillon veprimtarinë, rezulton se trendi i përgjithshëm i zhvillimit dhe performancës është pozitiv.

[31] Raport i vlerësimit të jashtëm.

[32] IDRA (Instituti për kërkime e zhvillim alternative) për Policimin në komunitet 2014

[33] Sondazhi i IDN 2016

[34] Programi Suedez SCPA, (Raport i PSH 2018)

Në mënyrë të përmbledhur, faktorët me ndikimin e tyre, paraqiten si më poshtë:

Nr.	Faktorët pozitivë (shanset)	Faktorët negativë (pengesat)
1	Kuadri ligjor i modeluar e përafruar me atë europerëndimor; statusi dhe parimet e veprimtarisë; kompetencat e mirëpërcaktuara në ligj dhe pavarësia e dhënë në veprimtarinë operacionale	Disa boshllëqe e pasaktësi në legjislacion dhe, veçanërisht, disharmonia midis dispozitave ligjore të SHÇBA-së e atyre të strukturave që janë objekt i punës; ligjeve që rregullojnë administratën dhe shërbimin civil; akteve nënligjore të shërbimit
2	Modeli i organizimit; përcaktimi i strukturave, përgjegjësive e rregullave të funksionimit; procedurat standarde për kryerjen e detyrave dhe angazhimi i qytetarëve për bashkëpunim, kundër keqsjelljes dhe abuzimeve me detyrën	Mosplotësimi i standardeve për çdo element të organizimit në sasi dhe në cilësi; në veçanti i: a) burimeve njerëzore të kualifikuara; b) sistemit të vlerësimit të performancës e të zhvillimit të karrierës dhe atij të shpërblimit në raport me treguesit e punës
3	Bashkëpunimi me aktorë të tjerë shtetërorë e të shoqërisë civile për marrjen e informacionit dhe eksperienca e fituar në trajtimin e tij dhe të ankesave të subjekteve të ndryshme për policimin, si dhe për hetimin e veprave penale të korrupsionit	Dobësitë në drejtimin e strukturave e punonjësve, shtimin e ngarkesës me punë dhe koordinimin me aktorë të tjerë, sidomos me drejtimin brenda organeve e strukturave që janë objekt i veprimtarisë
4	Politikat shtetërore kundër korrupsionit në përgjithësi dhe në veçanti reforma në sistemin e drejtësisë; vetingu në PSH e strukturat e tjera që përshihen në objektin e punës	Mangësitë në mjediset dhe kushte e punës dhe teknologjisë në përdorim, të cilat ndikojnë dukshëm në motivimin dhe eficiencën e punonjësve dhe shërbimit në tërësi
5	Mbështetja e gjithanshme e partnerëve ndërkombëtare (ICITAP, PAMECA, OSBE etj.) për zhvillimin e standardeve të shërbimit dhe kalimin gradualisht të tij në një shërbim të plotë civil	Rezistenca ndaj ndryshimit brenda strukturave të SHÇBA-së, si dhe të PSH-së e strukturave të tjera të cilat janë familjarizuar me gjendjen dhe tentojnë t'i trajtojnë (mbyllin) problemet brenda strukturave të tyre, jashtë vëmendjes e bashkëpunimit me SHÇBA-në
6	Mbështetja nga opinioni publik dhe veçanërisht, aktorë të shoqërisë civile, OJF dhe sipërmarrja private për të arritur një shërbim policor të kulturuar dhe eficient kundër abuzimeve me pushtetin e korrupsionin	Mosmbështetja sa duhet me fonde nga strukturat shtetërore, për të investuar në plotësimin e kushteve e të teknikës në përdorim, për të afruar një shërbim të shpejtë dhe profesional në mbikëqyrjen policore.

Duke vlerësuar faktorët e mësipërm, arrijmë në përfundimin se:

- SHÇBA-ja është modeluar e organizuar sipas parimeve dhe rekomandimeve të EPAC-së e të EAC-së për agjencitë që merren me luftën kundër korrupsionit. Infrastruktura ligjore e organizative përcakton qartë misionin, objektin e punës dhe përgjegjësitë, parimet e funksionimit, marrëdhëniet, kompetencat për kryerjen e detyrave etj., por referuar gjetjeve nga analizat e bëra dhe reformës së filluar në Drejtësi, ka nevojë për ndryshime e përmirësime të mëtejshme.

- Reforma në këtë Shërbim, në fillimet e veta hodhi baza të mira me infrastrukturën e re ligjore e organizative, por nuk vazhdoi më tej, për shkak të mungesës së një programi zhvillimi, mangësive në menaxhim dhe mbështetjen financiare, e pse jo edhe të vullnetit të drejtuesve.

- Treguesit e veprimtarisë së këtij Shërbimi për parandalimin e shkeljeve ligjore kanë trend pozitiv, por hetimi dhe ndëshkimi i veprave penale korruptive në radhët e policisë e strukturave të tjera është i ulët. Vlerësimi i organizmave ndërkombëtarë për korrupsionin në Shqipëri, ku përfshihet edhe Policia e Shtetit e strukturat e tjera, që janë në objektin e veprimtarisë së SHÇBA-së, përkon me vlerësimin e opinionit publik, çka do të thotë se veprimtaria e Shërbimit ka nevojë për ndryshime komplekse e të thella.

- Raportet e vetëvlerësimit të brendshëm e të atij të jashtëm, evidentojnë standardet e infrastrukturës ligjore dhe arritjet e këtij Shërbimi, por rekomandojnë bërjen e ndryshimeve e përmirësimeve të mëtejshme për ngritjen e plotësimin e standardeve.

- SHÇBA-ja administron vlera të mira pozitive, legjislacion të modelit perëndimor, burime njerëzore e materiale, eksperiencë pune, mbështetje të faktorit politik e aktorëve të tjerë shtetërorë; ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë të PAMECA-s, ICITAP-it, OSBE-së etj. dhe veçanërisht, të opinionit publik, i cili është shumë i interesuar për ndryshim e bashkëpunim.

I.8 Rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të standardeve

SHÇBA -ja e ka të domosdoshme:

"Të vazhdojë reformën e nisur, për të ndërtuar një Shërbim sipas modelit perëndimor dhe parimeve demokratike, të besueshëm, transparent dhe eficient për mbrojtjen e integritetit të strukturave e punonjësve, si dhe të të drejtave e lirive themelore të shtetasve, nga krimi dhe abuzimet e mundshme të autoritetit shtetëror".

Drejtimet, ku duhet përqendruar reforma për zhvillimin e standardeve të Shërbimit dhe për rritjen e performancës së tij në kryerjen e detyrave, duhet të jenë:

- zhvillimi i vlerësimit kalimtar dhe periodik brenda SHÇBA-së, në Policinë e Shtetit e strukturat e tjera, për të siguruar integritetin e punonjësve e të strukturave, qëndrueshmërinë në punë dhe besimin në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ligjit, qytetarëve dhe parandalimin e krimit;
- zhvillimi i standardeve të SHÇBA-së, për të ndërtuar një shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe të parimeve demokratike, duke përmirësuar e aktualizuar legjislacionin dhe procedurat e punë;
- përmirësimi i burimeve njerëzore dhe i atyre materiale e teknologjike, duke rekrutuar personel cilësor, duke rregulluar mjediset e punës dhe teknologjinë, si dhe duke përmirësuar sistemin e zhvillimit të karrierës e shpërblimit të punonjësve;
- përmirësimi i bashkëpunimit me strukturat që janë objekt i veprimtarisë; veçanërisht me strukturat e Prokurorisë (ndjekjes penale), opinionin publik dhe aktorë të tjerë shtetërorë, shoqërorë e të sipërmarrjes së lirë; për të mbrojtur të drejtat e liritë themelore të shtetasve nga shpërdorimi i autoritetit policor në çdo formë të shfaqjes së tij;
- rritja e performancës së Shërbimit, për parandalimin e shkeljeve të ligjit, duke i kushtuar kujdes trajtimit të ankesave të qytetarëve e subjekteve të tjera; inspektimit dhe mbikëqyrjes së policimit në bashkëpunim me komunitetin;
- rritja e profesionalizmit për hetimin dhe ndëshkimin e korrupsionit e veprave të tjera penale në radhët e punonjësve, duke përmirësuar procedurat e metodat e punës dhe duke përdorur me efikasitet kompetencat e mjetet ligjore.

KAPITULLI II
VLERAT, VIZIONI DHE MISIONI I SHÇBA-së

II.1 Vlerat

Veprimtaria e SHÇBA-së vlerëson dhe mbështetet, në:

- vlerat më të mira që mbart populli shqiptar;
- sistemin e legjislacionit të brendshëm dhe kuadrin ligjor ndërkombëtar;
- vlerat e Shërbimit dhe të punonjësve të tij, të shprehura në legjislacion, aktet e brendshme normative, himnin, flamurin dhe simbolet;
- parimet e rëndësishme të besueshmërisë, efikasitetit, objektivitetit, transparencës, eficiencës e llogaridhënies dhe integritetin e punonjësve në detyrë;
- arritjet e Shërbimit për mbikëqyrjen e Policisë; mbrojtjen e integritetit të saj dhe të punonjësve nga shkeljet ligjore e veprat korruptive;
- besimin dhe gatishmërinë e opinionit publik, aktorëve të tjerë shtetërorë dhe sipërmarrjes së lirë për të bashkëpunuar e për të ndihmuar Shërbimin.

II.2 Vizioni

Vizioni i SHÇBA është:

SHÇBA-ja, bazuar në vlerat e shoqërisë shqiptare, nevojat e komunitetit për siguri dhe mbrojtje të të drejtave e lirive themelore, si dhe në vlerat e punonjësve të tij: do të punojë me përkushtim, në bashkëpunim me qytetarët dhe aktorët e tjerë shtetërorë, për të mbrojtur integritetin e Policisë, strukturave të tjera të përcaktuara në ligj dhe të punonjësve të tyre; të drejtat e qytetarëve dhe dinjitetin njerëzor; si dhe për t'u siguruar punonjësve trajtim të merituar, mbrojtje dhe karrierë të suksesshme.

Drejtimi i SHÇBA-së duhet të përcjellë në mënyrë të vazhdueshme e me të gjitha mjetet te punonjësit e vet dhe opinioni publik:

a) deklaratën e vizionit;

b) misionin e ngarkuar nga ligji, për t'i njohur dhe për t'i përdorur ato si busull orientuese në veprimtarinë e përditshme.

Vizioni është rrjedhojë logjike e analizës së faktorëve të brendshëm dhe të atyre të mjedisit të jashtëm. Ai bazohet në misionin e ngarkuar nga ligji, vlerat dhe burimet që administrohen, si dhe nevojat që kanë strukturat që përbëjnë objekt të veprimtarisë dhe vetë opinioni publik.

Vizioni shpreh atë çka SHÇBA-ja dëshiron të jetë dhe të bëjë për qytetarët dhe punonjësit e saj, duke konsideruar vlerat e përmendura më sipër dhe

arritjet në kryerjen e detyrave; burimet e vëna në dispozicion; për të siguruar standarde të përafërta të shërbimit me ato të vendeve të BE-së dhe për të garantuar integritet të lartë të strukturave dhe punonjësve të tyre që përcaktohen në ligj.

II.3 Misioni

Misioni i SHÇBA-së është:

Garantimi i zbatimit të ligjit, mbrojtja e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada (neni 4).

Misioni i formatuar nga ligjvënësi është i ndërtuar e bazohet mbi këto vlera dhe i përdor ato për përmbushjen e detyrave në mbrojtje të interesit publik, të të drejtave e lirive të qytetarëve. Në thelb të misionit, ligji ka vendosur: "mbrojtjen e interesave të shtetit (garantimin e pastërtisë e integritetit të strukturave ligjzbatuese dhe punonjësve të tyre), si dhe "mbrojtjen e të drejtave të qytetareve" nga shpërdorimi i autoritetit shtetëror.

Misioni dhe përgjegjësitë e ngarkuara nga ligji e shoqëria për shërbimin nuk mund të realizohen nga punonjësit, sado të zotë qofshin, nëse ata nuk kanë integritet të lartë si individë dhe organizatë, që do të thotë se ata duhet të jenë me cilësitë më të mira morale e profesionale; të gëzojnë besimin e punonjësve të strukturave që mbikëqyrin dhe njëherësh opinionit publik, të cilit i shërbejnë.

Është përgjegjësi e drejtuesve të Shërbimit dhe të strukturave në çdo nivel, për t'iu përkushtuar sigurimit të vlerave në radhët e veta; si dhe promovimit të vazhdueshëm e përdorimit të tyre për motivimin e punonjësve në kryerjen e detyrave, si kusht për zhvillimin e standardeve dhe treguesve të punës.

Sfidat para Shërbimit

Veprimtaria që përbën sfidë për SHÇBA-në, mund të sintetizohet në: "Eficiencën për të mbikëqyrur ushtrimin e autoritetit policor e të strukturave të tjera ligjzbatuese dhe për të parandaluar shkeljet e ligjshmërisë e korrupsionin, me qëllim që të mbrohen gjithnjë e më mirë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve".

Lufta kundër paligjshmërisë dhe korrupsionit në veprimtarinë e strukturave, nuk duhet kuptuar e fokusuar vetëm te ndryshimet ligjore apo te punonjësit e veçantë që abuzojnë në polici, por te zhvillimi i standardeve të organizatës dhe të policimit, duke forcuar integritetin e kombinuar masat parandaluese me ato shtrënguese, si dhe duke bashkërenduar veprimet me institucionet e tjera shtetërore, ato të drejtësisë e komunitetin.

Sfidat e SHÇBA-së janë arritja e standardeve të institucionit dhe të veprimtarisë së tij, sipas atyre që kanë Shërbimet homologe të vendeve të Bashkimit Evropian; të cilat materializohen e zbërthehen në dokumentin strategjik të zhvillimit dhe Planin e veprimit.

Sfidat mund t'i specifikojmë në:

- forcimin e integritetit dhe të standardeve të Shërbimit sipas shërbimeve homologe të BE-së, duke konsoliduar funksionimin institucional si shërbim civil i hapur, i pavarur, i besueshëm, eficient, transparent dhe i kontrollueshëm;
- rritjen e besimit të punonjësve të Policisë dhe të strukturave të tjera që përfshihen në objektin e veprimtarisë, si dhe të opinionit publik për rolin e Shërbimit;
- parandalimin (uljen) e korrupsionit dhe të shkeljeve të ligjshmërisë në radhët e strukturave e të punonjësve, nëpërmjet rritjes së eficiencës së veprimtarisë parandaluese e hetimore dhe uljes së ankesave të qytetarëve dhe veprave penale.

II.4 Parimet bazë të SHÇBA-së

Parimet e SHÇBA-së janë të shprehura në ligjin organik, si dhe në të gjithë paketën ligjore që rregullon organizimin dhe veprimtarinë e Shërbimit. Referuar EPAC-së dhe ENAC-së, ato janë:

"E drejta ligjore" nënkupton kuadrin ligjor që krijon këtë Shërbim dhe normon statusin, objektin e punës, parimet, organizimin, kompetencat e mjetet ligjore etj.;

"Pavarësia" do të thotë mundësia (e drejta) për të ushtruar funksionet pa u ndikuar; liria për të vepruar, hetuar pa u ndikuar nga askush, përveç ligjit;

"Llogaridhënia" rrjedh nga misioni dhe natyra e Shërbimit, i cili duhet të japë llogari për kryerjen e detyrave; për të pasur besimin e publikut, si dhe përgjigjet për veprimet që kryen;

"Integriteti e paanësia" nënkupton të qenët dhe veprimtaria të jenë në përputhje me vlerat morale e profesionale, të vepruarit në mënyrë të pavarur nga çdo lloj paragjykimi;

"Aksesimi" nënkupton të drejtën për të marrë informacionet e dhëna nga gjithë aktorët shtetërorë, shoqërorë e privatë dhe të veprojë me objektivitet në punë;

"Transparenca dhe besueshmëria" nënkupton që Shërbimi, në veprimtarinë që kryen, të veprojë me drejtësi e pavarësi dhe të informojë opinionin publik;

"Sigurimi i burimeve" do të thotë që strukturat përgjegjëse publike t'i vënë në dispozicion mjediset, kushtet, teknikën dhe burimet e nevojshme financiare, për kryerjen e detyrave;

"Sigurimi i personelit" nënkupton pavarësinë për zgjedhjen e tij nëpërmjet konkurrimit, me integritet të lartë, aftësi profesionale dhe të aftë për kryerjen e detyrave;

"Bashkëpunimi" është kusht, pa të cilin nuk mund të ketë sukses, për rrjedhojë ai duhet të formalizohet e të realizohet brenda strukturave, midis institucioneve, me strukturat e Prokurorisë dhe homologët ndërkombëtarë.

KAPITULLI III
PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Prioritetet e SHÇBA-së, për vitet 2020–2024, janë:

1. Forcimi i integritetit të strukturave ligjzbatuese në Ministrinë e Brendshme (Vetingu), për të mbrojtur e për të pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e strukturave dhe të punonjësve, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në legjislacion.

2. Zhvillimi i standardeve të SHÇBA-së për të krijuar një Shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe të parimeve demokratike, të hapur, dinamik, të besueshëm, efikas dhe eficient, transparent e të kontrollueshëm.

3. Përmirësimi i menaxhimit të Shërbimit, si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet objekt i veprimtarisë së Shërbimit, opinionin publik dhe institucione të tjera publike e jopublike.

4. Rritja e performancës për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit, korrupsionit e veprave të tjera penale në radhët e punonjësve të organeve, për të mbrojtur integritetin dhe veprimtarinë e rregullt shtetërore dhe të drejtat e liritë themelore të shtetasve.

SHÇBA-ja duhet t'u dërgojë një sinjal të fortë gjithë aktorëve shtetërorë dhe opinionit publik, se: "do të punojë mirë, do të jetë e hapur dhe e afrueshme dhe nuk do të tolerojë shkeljet ligjore, abuzimin me pushtetin, korrupsionin dhe neglizhencën ndaj detyrës dhe as nuk do të mbulojë ndonjë keqbërje".

Organizimi punës për përmbushjen e prioriteteve strategjike

III.1 PRIORITETI I PARË

Forcimi i integritetit të strukturave ligjzbatuese në Ministrinë e Brendshme (Vetingu) për të mbrojtur e pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e strukturave dhe punonjësve, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në legjislacion.

Për realizimin e këtij prioriteti do të punohet në mënyrë të organizuar, sipas programit të veçantë, duke konsideruar faktorët e brendshëm, si dhe rekomandimet e bëra nga organizmat e partnerët perëndimorë.

OBJEKTIVI 1.1

Zhvillimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve, për të mbrojtur e për të pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e strukturave dhe të punonjësve, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në legjislacion.

Gjatë vitit 2020 do të ndërtohet infrastruktura e nevojshme ligjore, si dhe në aspektin e burimeve njerëzore për fillimin e rivlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Kjo do të arrihet duke:

- hartuar projektaktet nënligjore për vlerësimin kalimtar dhe periodik të subjekteve të Shërbimit, sipas ligjit 12/2018;
- krijimin e kushteve infrastrukturore për personelin e vlerësimit;
- marrë përgjegjësitë ligjore, sipas ligjit nr. 12/2018, për nisjen e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik ndaj subjekteve të Shërbimit, duke bashkëpunuar ngushtë edhe më Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit;
- rritur bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese për verifikimin e integritetit të subjekteve të Shërbimit, si dhe rritja e bashkëpunimit me DSIK-në si struktura kryesore e vlerësimit për CSP-në (Certifikatë e Sigurimit të Personelit).

OBJEKTIVI 1.2

Qasja moderne për të përmirësuar integritetin e policisë

Në bashkëpunim me Misionin Policor PAMECA V do të:

- organizohen trajnime dhe do të përcaktohen grupet e punës për përgatitjen e hartës së analizës

së riskut, si dhe masat që do të merren për të parandaluar e për të luftuar riskun e korrupsionit në strukturat ligjzbatuese të Ministrisë së Brendshme e, në mënyrë të veçantë, në Policinë e Shtetit.

- do të identifikohen problematikat dhe fenomenet që shqetësojnë forcat e zbatimit të ligjit në Ministrinë e Brendshme.

- do të hartohen e rishikohen memorandumet e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Kosovës, "Mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm".

- do të rishikohen memorandumet e bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë, "Mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm".

- do të rishikohet memorandumi i bashkëpunimit "Mbi shkëmbimin e informacionit, kryerjen e operacioneve të përbashkëta dhe kryerjen e testit të integritetit ndërmjet Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave".

III.2 PRIORITETI I DYTË

Zhvillimi i standardeve të SHÇBA-së, për të krijuar një Shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe të parimeve demokratike, të hapur, dinamik, të besueshëm, efikas dhe eficient, transparent e të kontrollueshëm.

Zhvillimi i standardeve të SHÇBA-së dhe përafrimi i tij me atë të Agjencive homologe perëndimore, konsiderohet prioritet, për arsye se prej nivelit e funksionimit të tij, varen të gjithë treguesit, pra edhe performanca e veprimtarisë që ushtron. Është kjo arsyeja që e gjithë infrastruktura ligjore e organizative duhet të përmirësohet, për të plotësuar e për të përafruar legjislacionin me atë europerëndimor, për të përsosur organizimin dhe funksionimin e brendshëm, si dhe për të siguruar burimet e duhura e cilësore për kryerjen e detyrave.

Zhvillimi i standardeve do të arrihet, duke punuar për realizimin e objektivave të mëposhtëm:

OBJEKTIVI 2.1

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore e organizative (ligjit organik të SHÇBA-së, akteve të tjera nënligjore, organizimit e funksionimit të Shërbimit) dhe përafrimi me ato të vendeve perëndimore, për të rritur eficiencën e Shërbimit dhe për të përmbushur misionin e ngarkuar.

Qëllimi është që legjislacioni dhe aktet e tjera plotësuese të përshtaten e të harmonizohen me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni për reformën në sistemin e drejtësisë e sidomos në Prokurori, për SPAK-un, BKH-në, Policinë Gjyqësore; Kodin Penal dhe atë Procedural Penal, vetingun në Strukturat e Policisë e sigurimit të personaliteteve.

Kjo do të arrihet duke:

a) analizuar legjislacionin dhe paketën ligjore mbi Shërbimin, për të vlerësuar boshllëqet, kundërshtitë dhe problematikën e dalë gjatë zbatimit; si dhe kuadrin ligjor për reformën në drejtësi dhe strukturat e reja që krijohen (në sistemin e Gjyqësorit, në Prokurori për SPAK-un, BKH-në, Policinë Gjyqësore), si dhe për të evidentuar ndryshimet e detyrimet ligjore;

b) organizuar diskutime për tërheqjen e mendimeve e të sugjerimeve brenda strukturave të Shërbimit; atyre të Policisë e strukturave të tjera, strukturave të drejtësisë, si dhe organizmave të shoqërisë civile që kontribuojnë për zbatimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit;

c) përgatitur projektligjin për ndryshimet e plotësimet në ligjin ekzistues, si dhe ripunuar të gjitha aktet nënligjore të brendshme për mirëfunksionimin e SHÇBA-së.

Në ndryshimet e paketës ligjore do të duhet të:

a) saktësohet statusi i institucionit dhe objekti i veprimtarisë, duke shtuar edhe organe e struktura të tjera të ministrisë;

b) rregullohen më saktësisht raportet e drejtuesit të Shërbimit me ministrin dhe drejtuesit e strukturave që janë objekt i veprimtarisë;

c) harmonizohen dispozitat e ligjit me ato të ligjit për Policinë e Shtetit, ligjit për Policinë Gjyqësore, atij për SPAK-në, administratën publike, atij për nëpunësin civil; si dhe me paketën e akteve normative të brendshme;

d) përmirësohet sistemi i matjes dhe i vlerësimit të punës, trajtimit të punonjësve dhe ai i promovimit në detyrë etj.;

e) përmirësohen të gjitha aktet e brendshme normative në formë përmbajtjeje, për t'i shërbyer më mirë funksionimit të strukturave e punonjësve.

Struktura organizative, mbi bazën e standardeve të njësive të mbikëqyrjes policore (të miratuara nga EPAC-ja), gjetjeve nga vlerësimet e bëra dhe nevojave për ta bërë sa më funksionale, do të përmirësohet në elemente të veçanta, duke:

a) riformatuar organizimin ekzistues brenda ministrisë së brendshme për të ndërtuar një organ të centralizuar, me integritet të lartë, që vepron mbi bazën e parimeve demokratike, duke saktësuar statusin si "organ i administratës shtetërore"; zgjeruar përgjegjësitë institucionale (objektin e punës) e të tjera ndryshime të cituara më sipër;

b) përcaktuar përgjegjësitë lëndore të strukturave; ndarë përgjegjësitë administrative e menaxheriale të drejtuesve në nivelin qendror nga ato të hetimit e operacionale të strukturave të tjera në vartësi; formatuar përgjegjësitë e strukturës së vetingut; si dhe ato për çdo funksion (pozicion pune); vartësinë dhe raportet midis tyre; kompetencat që ushtrojnë etj.;

c) përcaktuar limitin organik të personelit dhe statusin e dyfishtë (gradë dhe civil), në vartësi të detyrave e kompetencave që ushtrojnë, me synim që në një të ardhme të afërt (faza e dytë), i gjithë shërbimi të kthehet me status civil dhe formimi kulturor e profesional t'u përshtatet detyrave e kompetencave që do të ushtrojnë (për zbatimin e ligjit);

d) përforcuar kriteret e rekrutimit të personelit për të përmirësuar cilësinë, profesionalizmin dhe etikën në sjelljen e punonjësve; sistemin e vlerësimit të punës me indikatorë konkretë, atë të promovimit në gradë e detyrë, trajtimit me pagesë, si dhe monitorimit të jashtëm nga komuniteti.

OBJEKTIVI 2.2

Sigurimi i burimeve të duhura (njerëzore, materiale, financiare e teknologjike), për të krijuar kushtet e nevojshme dhe për të motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.

Sigurimi i burimeve për këtë institucion është një kusht, pa të cilin nuk mund të realizohen detyrimet ligjore dhe objektivat e përcaktuar në këtë dokument dhe programe të tjera pune. Strukturat vendimmarrëse duhet të mbajnë në vëmendje, se personeli i pamjaftueshëm e i pakualifikuar, si dhe sistemi i dobët informativ për menaxhimin e informacionit, ankesave e hetimeve, sjell efekte negative për shërbimin dhe qytetarët.

Për realizimin e objektivit duhet përqendruar në:

a) rivlerësimin e personelit ekzistues, pas vetingut, për të testuar nivelin dhe aftësitë profesionale; rivendosur atë në poste pune sipas vlerave profesionale e nevojave të shërbimeve, nëpërmjet një konkurrimi të hapur;

b) përforcimin e kritereve, standardeve e procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj; ato të vlerësimit të punës, të shpërblimit, si dhe promovimit në detyrë;

c) kualifikimin e punonjësve në përshtatje me detyrat dhe me kompetencat që do të ushtrojnë, duke bashkëpunuar me AS-në e partnerët ndërkombëtarë që asistojnë struktura të MB-së;

d) në ndryshim nga praktika e viteve të mëparshme është e domosdoshme, që reforma për ndryshimin e standardeve të këtij Shërbimi, të vlerësohet dhe shoqërohet me investime financiare prioritare;

e) marrjen e masave për krijimin e kushteve normale të punës dhe bazës materiale e teknike për të gjitha strukturat e punonjësit nga niveli qendror në atë vendor. Për këtë duhet punuar me grup të veçantë pune, i cili do të përgatisë studimin për gjendjen ekzistuese dhe mundësitë që ekzistojnë, si dhe programin për ndryshim të gjendjes nëpërmjet investimit apo ndërhyrjes te mjediset aktuale, i shoqëruar ky me projekte dhe kostot përkatëse;

f) sigurimin dhe instalimin e projekteve e të programeve të reja të teknologjisë bashkëkohore, në funksion të nevojave e proceseve të punës që ka Shërbimi, si për shkëmbimin dhe administrimin e informacionit, menaxhimin e çështjeve penale të iniciuara deri në përfundimin e tyre, analizën e informacionit etj., të shoqëruara këto me kostot përkatëse dhe burimet e sigurimit të tyre;

Për modernizimin e Shërbimit me investime në fushë e IT-së me programe analitike kompjuterike, duhet të punohet me program dhe grup specialistësh, për të realizuar:

a) projekte konkrete inxhinerike;

b) ndërtime infrastrukturore teknologjike,

c) llogaritjen e kostove financiare dhe sigurimin e fondeve,

d) llogaritjet e limiteve organike.

Informatizimi i veprimtarisë së Shërbimit do të ndikojë në rritjen e kapacitetit të punës për qarkullimin e informacionit dhe hetimin e veprave penale, si dhe përmirësimin e performancës së Shërbimit në të gjitha drejtimet e aktivitetit të tij.

OBJEKTIVI 2.3

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit në të gjitha nivelet për të siguruar një shërbim efikas dhe transparent për të menaxhuar burimet dhe për të motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave.

Ky objektiv synon të ndryshojë menaxhimin dhe stilin e drejtimit të SHÇBA-së: për të motivuar më mirë punonjësit dhe për të rritur rendimentin në kryerjen e detyrave; për të forcuar imazhin e Shërbimit dhe për të arritur besueshmërinë e publikut. Drejtimi i organit dhe vetë punonjësit e Shërbimit duhet:

- Të jenë të qartë mbi statusin dhe misionin e ngarkuar nga ligji, i cili është Shërbim publik për të mbrojtur vlerat dhe integritetin e strukturave e punonjësve; çka do të thotë se veprimtaria informative apo përgjegjësi të tjera institucionale janë kompetenca apo mjete ligjore të dhëna për përmbushjen e misionit e kryerjen e detyrave dhe kurrsesi nuk mund të zëvendësojnë misionin. Tendenca për ta trajtuar procesin informativ si mision i dhënë në dëm të përgjegjësive të tjera është e gabuar, sepse e shndërron SHÇBA-në në një agjenci informativo-gjurmuese dhe e shmangin nga kryerja e funksioneve parandaluese e atij të Policisë Gjyqësore për hetimin e krimit.

- Të përcjellin, kërkojnë e vlerësojnë aftësinë dhe kompetencat e personelit për njohjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe procedurave të punës, si dhe të përsosin menaxhimin e punëve, duke harmonizuar funksionet menaxheriale; analizën, planifikimin, organizimin, drejtimin (udhëheqjen) dhe monitorimin (kontrollin).

- Të harmonizojnë veprimtarinë (parandaluese e hetimore), në përshtatje me tendencat e shkeljeve ligjore, abuzimeve me autoritetin policor dhe veprave korruptive që zhvillohen. Kjo do të thotë që Shërbimi të fokusohet te parandalimi i shkeljeve ligjore e i korrupsionit, nëpërmjet menaxhimit të gjithë burimeve dhe mjeteve ligjore (kompetencave); angazhimit të aktorëve përgjegjës brenda PSH-së, si dhe strukturave të tjera; aktorëve shtetërorë e, veçanërisht, ata të shoqërisë civile, dhe njëherësh shoqëruar me rritjen e treguesve për zbulimin dhe hetimin objektiv të të gjitha rasteve kur individët kryejnë vepra të kundërligjshme.

Më konkretisht, drejtimi do të fokusohet tek:

a) zhvillimi i analizave për njohjen e gjendjes; të natyrës periodike, atyre të riskut për drejtime e forma të veçanta të shkeljeve e abuzimeve me detyrën; analizave të përbashkëta me strukturat që janë objekt i veprimtarisë, si dhe me Prokurorinë për procedimet penale, duke e kthyer këtë në një kulturë pune;

b) realizimi i veprimtarisë së organit dhe çdo strukture apo punonjësi në mënyrë të planifikuar, me synime, objektiva e detyra të qarta, të nxjerra nga detyrimet ligjore dhe gjendja e faktorëve, me indikatorë konkretë për matjen e punës;

c) përsosja e komunikimit me punonjësit, për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të shfrytëzuar energjitë e tyre, duke i njohur me problemet dhe e i angazhuar në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e tyre;

d) organizimi dhe drejtimi nga afër i strukturave vendore e operacionale për realizimin e veprimtarive të ndryshme, duke i kushtuar kujdes sigurimit të burimeve të nevojshme njerëzore, teknike e financiare, si dhe matjes së performancës së gjithsecilit.

III.3 PRIORITETI I TRETE

Përmirësimi i menaxhimit të Shërbimit, si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet objekt i veprimtarisë së Shërbimit, opinionin publik dhe institucione të tjera publike e jopublike.

Mbrojtja e integritetit dhe e veprimtarisë së rregullt të PSH-së dhe e strukturave të tjera të përcaktuara në ligj nga shkeljet ligjore, shpërdorimi i pushtetit dhe veprat korruptive edhe pse është përcaktuar si detyrë e SHÇBA-së është e vështirë të realizohet pa përsosur bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, prokurorinë, agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe opinionin e gjerë publik.

Për rrjedhojë, Shërbimi duhet ta trajtojë bashkëpunimin si "kusht pa të cilin" nuk mund të përmbushen detyrat apo të institucionalizojë këtë proces dhe të punojë në mënyrë të vazhdueshme për forcimin e tij. Kjo veprimtari do të ndiqet duke realizuar objektivat e mëposhtëm:

OBJEKTIVI 3.1

Forcimi i bashkëpunimit me strukturat që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit dhe punonjësit e tyre; strukturat e agjencitë e tjera publike dhe ato homologe të rajonit e më gjerë.

Në ndryshim nga tradita e deritanishme, ku për bashkëpunimin nuk ka pasur asnjë funksion përgjegjës dhe ai është trajtuar si përgjegjësi e drejtuesve të nivelit të lartë dhe është realizuar sipas rasteve e çështjeve të lindura nga dinamika e punës, pas riorganizimit do të jetë i institucionalizuar në kuadrin ligjor e aktet normative dhe do të ushtrohet si përgjegjësi nga të gjitha nivelet e

punonjësit, në mënyrë të planifikuar e kontrolluar. Bashkëpunimi do të përqendrohet, me:

Strukturat dhe punonjësit e PSH-së dhe strukturave të tjera që janë objekt i veprimtarisë. Qëllimi është për të ndërtuar marrëdhënie besimi e të ndershme; për të mbrojtur vlerat dhe integritetin e strukturave e punonjësve, si dhe për t'i paraprirë zgjidhjes së problemeve homologe që funksionojnë në vende të rajonit e më gjerë etj.

OBJEKTIVI 3.2

Forcimi i bashkëpunimit me Prokurorinë, për të ngritur treguesit e hetimit të veprave penale dhe korrupsionit në radhët e punonjësve të zbatimit të ligjit.

Qëllimi është që SHÇBA-ja të ndryshojë cilësisht metodologjinë e punës në funksion të hetimit të veprave penale e korrupsionit në radhët e punonjësve të Policisë e strukturave të tjera, duke rritur profesionalizmin, objektivitetin dhe shpejtësinë e hetimeve.

Për sa me lart, do të punohet për:

a) rivlerësimin dhe kolaudimin e akteve normative të bashkëpunimit me strukturat e Prokurorisë (SPAK dhe BKH) dhe ato të brendshme e procedurave të punës për hetimin e veprave të mundshme penale që mund të kryhen nga punonjësit;

b) analizimin e materialeve që kanë indicie për vepra penale të korrupsionit dhe për përcaktimin e detyrave që duhen realizuar në funksion të zbulimit e sigurimit të provave;

c) Realizimin e detyrave të caktuara apo të deleguara nga prokuroria për çështje të referuara, si dhe për të tjera që mund të fillohet ndjekja penale;

d) Përdorimin e mjeteve të reja ligjore të dhëna nga ligji procedural penal për sigurimin e provave ligjore (bashkëpunimi, përgjimi, infiltrimi etj.).

OBJEKTIVI 3.3

Forcimi i bashkëpunimit me publikun: medien, organizma të shoqërisë civile, sipërmarrjen e lirë dhe qytetarët, për të rritur besimin dhe mbështetjen në kryerjen e detyrave.

Synimi është që të njihen më mirë e në kohën e duhur vlerësimi i qytetarëve për shërbimet e sigurisë publike; shqetësimet që kanë; të ndërgjegjësohen për rolin e SHÇBA-së në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe nevojën për t'u angazhuar kundër paligjshmërisë dhe abuzimeve në detyrë.

- Për realizimin e objektivit do të punohet me program të veçantë, për të ndryshuar filozofinë e bashkëpunimit dhe të komunikimit, për të institucionalizuar atë dhe për të shndërruar në një normë të detyrueshme dhe kulturë të përhershme pune. Filozofia e re duhet të ndryshojë praktikën e punës së mbyllur dhe të trajtimit të çështjeve sipas rastit, në një komunikim të vazhdueshëm, për të rritur besimin e publikut, për të përmirësuar imazhin e Shërbimit dhe për të siguruar mbështetjen e tij.

- Komunikimi do të trajtohet si kusht për zhvillimin e veprimtarisë së Shërbimit dhe përqendrohet tek bindja mbi rolin e Shërbimit; gjetjet dhe anketimi i opinionit publik, ngjarjet brenda radhëve të punonjësve të strukturave; mënyrat e bashkëpunimit, si dhe probleme të tjera me interes për opinionin publik.

- Për arritjen e objektivit do të shtohen format e komunikimit për të ndërgjegjësuar opinionin dhe për të siguruar mbështetjen e tij, duke:

a) riformatuar dhe përdorur faqen e internetit për SHÇBA-në, në mënyrë të vazhdueshme me informacion për treguesit e punës së Shërbimit; ngjarje të rënda që kanë ngjallur interes; pjesëmarrje në krim e korrupsion të punonjësve, studime e anketime të bëra;

b) shfrytëzuar linjën e ankimimit të qytetarëve me telefon dhe me mjete të tjera, në mënyrë elektronike, për të mbajtur kontakt dhe për të mësuar në kohë ankesat dhe informacionet e qytetarëve;

c) rritur më shumë transparencën për informim dhe trajtim të problemeve e shqetësimeve që dalin, duke shtuar bashkëpunimin me medien e shkruar e atë televizive nëpërmjet shkrimeve e emisioneve të veçanta;

d) përgatitur dhe shpërndarë buletine informuese periodike, fletëpalosje, spote të ndryshme në shkolla, institucione publike, OJF, mjedise publike e qendra banimi;

e) inkurajuar dhe shfrytëzuar forumet publike të ngritura në komunitet, për të dëgjuar ankesat e shqetësimet e qytetarëve, si dhe për të organizuar kontrollin e jashtëm qytetar në bashkëpunime edhe me strukturat e PSH-së për policimin në komunitet;

f) tërhequr vlerësimin e opinionit publik nëpërmjet anketimit që do të shndërrohet në një instrument matës vjetor të vazhdueshëm për

problemet e korrupsionit, sjelljes së punonjësve të mbrojtjes së ligjit dhe të sigurisë publike. Anketimi i opinionit do të realizohet duke bashkëpunuar me botën akademike dhe OJF të profilizuara.

III.4 PRIORITETI I KATËRT

Rritja e performancës për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit, korrupsionit e veprave të tjera penale në radhët e punonjësve të organeve, për të mbrojtur integritetin dhe veprimtarinë e rregullt shtetërore dhe të drejtat e liritë themelore të shtetasve.

SHÇBA-ja, sipas përcaktimit të ligjit, ka përgjegjësinë: "për parandalimin, identifikimin dhe hetimin e veprave penale dhe të shkeljeve të tjera ligjore, të kryera nga punonjës të strukturave ..." (neni 5). Dispozita e mësipërme i jep Shërbimit pushtetin dhe autoritetin për hetuar shkeljet e ligjit të kryera nga punonjës të veçantë të strukturave, të cilat mund të jenë të natyrës disiplinore, asaj administrative dhe vepra penale.

Parandalimi e zbulimi i shkeljeve ligjore dhe i veprave korruptive përbën përgjegjësinë kryesore të ngarkuar nga ligji dhe shoqëria, për realizimin e të cilit duhen përmbushur detyrat dhe duhen ushtruar kompetencat e mjetet ligjore, në bashkëpunim me aktorët e tjerë shtetërorë e shoqërorë.

Ky drejtim i punës kërkon që të gjitha burimet dhe mjetet ligjore të orientohen tek:

Së pari: funksionimi organizativ e institucional i Policisë së Shtetit dhe i strukturave të tjera. Kjo do të thotë që brenda objektit të punës e të rregullave të caktuara të mësohet në kohë funksionimi i sistemeve, procedurave, drejtimit, ushtrimi i fuqisë (forcës) dhe i kompetencave të tjera ligjore, për rekrutimin e promovimin e punonjësve, zbatimin e Kodit të Etikës; hapjen e policisë me publikun, funksionimin e kontrollit të brendshëm, administrimin e burimeve dhe marrjen e vendimeve, qëndrimin ndaj veprave korruptive nga drejtuesit, angazhimin e kontrollit të jashtëm etj.;

Së dyti: format e shkeljeve ligjore, e korrupsionit dhe e punonjësit që i kryen ato, duke u fokusuar në shërbimet e qarkullimit rrugor, ato të kufirit e emigracionit, strukturat që merren me burimet njerëzore, krimin ekonomiko-financiar, shërbimet ndaj të tretëve, tenderimet etj. Ndër format e mësipërme duhen dalluar shkeljet e natyrës disiplinore, administrative e keqsjelljet për shkak të paaftësisë apo të kujdesit nga veprimet me dashje për motive përfitimi, të cilat përbëjnë vepra penale.

Së treti: korrupsioni i lidhur me krimin, i shprehur ky me veprime e mosveprime, duke ndihmuar autorët e krimeve dhe krimin e organizuar për t'i shpëtuar përgjegjësisë ligjore dhe realizuar qëllimet e tyre; pa nënvleftësuar këtu edhe korrupsionin politik të shprehur nëpërmjet shkeljes së përgjegjësive e detyrave dhe vënies në dispozicion të ndikimit politik.

Kjo veprimtari do të arrihet duke punuar për objektivat e mëposhtëm.

OBJEKTIVI 4.1

Sigurimi i informacionit duke përdorur të gjitha burimet dhe mjetet e mundshme ligjore dhe administrimi i tij për njohjen e gjendjes, parandalimin e zbulimin e veprave korruptive.

Informacioni në veprimtarinë e Shërbimit është me rendësi të veçantë, sepse nëpërmjet tij mund të mësohen shkeljet e ligjshmërisë dhe veprat penale që kryhen në mënyrë të fshehtë, larg vëmendjes së publikut.

Ky objektiv duhet t'i paraprijë gjithë veprimtarisë që kryen organi për të mësuar veprat kriminale dhe për t'iu kundërpërgjigjur në kohë atyre. Për rrjedhojë, strukturat dhe punonjësit duhet ta vlerësojnë dhe të punojnë në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur të gjitha burimet, mjetet, metodat dhe procedurat ligjore.

Realizimi i objektivit do të arrihet, duke:

- rivlerësuar e ripunuar gjithë procesin që rregullon sigurimin, administrimin dhe përdorimin e informacionit për njohjen e paligjshmërisë së veprave korruptive dhe parandalimin e goditjen e tyre. Veprimtaria informative, si proces, do të institucionalizohet duke unifikuar burimet, format, teknikat dhe procedurat (të shprehura aktualisht në shumë akte normative), në një akt të vetëm normativ, me qëllim që të thjeshtohen procedurat nga veprimet burokratike dhe të lehtësohet puna e strukturave përgjegjëse;
- rivlerësuar dhe seleksionuar në konformitet me legjislacionin të gjitha materialet operative e administrative të grumbulluara ndër vite; informatizuar ato dhe vënë në përdorim për hetimin e çështjeve e problemeve të ndryshme;
- organizuar punën për të siguruar, analizuar dhe përdorur informacionin që jepet nga burimet e hapura, si: qytetarët, personat e dëmtuar nga shkeljet ligjore dhe viktimat e krimit, media e

shkruar e ajo televizive, OJQ-të dhe organizma të tjerë të shoqërisë, agjenci e institucione shtetërore, si dhe nga shërbimet e strukturave që janë objekt i veprimtarisë dhe rrjeti informativ i bashkëpunëtorëve etj.;

- përfshirë konceptet e reja dhe metodat shkencore për analizën e informacionit kriminal, duke rivlerësuar metodologjinë. Kjo kërkon ndryshim të punës në strukturën e analizës, duke instaluar programe të reja pune dhe rritur kualifikimin;

- administruar dhe përdorur informacionin që sigurohet nga përdorimi i kompetencave dhe i mjeteve ligjore, si kryerja e veprimeve të para procedurale në raste të veprave penale në flagrancë; marrja në pyetje e personave që kanë dijeni, bërja e vëzhgimeve, filmimeve e përgjimeve etj.

OBJEKTIVI 4.2

Trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe i subjekteve të ndryshme, me objektivitet e transparencë.

Ligji shprehet se SHÇBA-ja ka kompetencën, për: "të regjistruar, administruar dhe trajtuar gjitha ankesat ndaj punonjësve të strukturave të PSH-së për mospërmbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit" (neni 5).

Për rrjedhojë, trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe i subjekteve të ndryshme përbën një nga drejtimet dhe përgjegjësitë kryesore të punës dhe si i tillë duhet vlerësuar e përmbushur seriozisht.

Qëllimi i objektivit është të mbrohen e të zgjidhen të drejtat e ankuesve të cenuara nga punonjësit e zbatimit të ligjit dhe njëherësh të ulen në maksimum rastet e shkeljeve e të abuzimeve në detyrë; të ngrihen standardet e Shërbimit dhe të mbrohet integriteti i strukturave në Shërbim të shtetit e qytetarëve.

Për të realizuar objektivin, Shërbimi do të:

- rivlerësojë e përforcojë sistemin e pranimit e trajtimit të ankesave, duke përcaktuar strukturat përgjegjëse, rregullat dhe procedurat e punës standarde që ndiqen, si dhe për të trajnuar personelin për këtë Shërbim;

- krijojë kushtet me mjediset dhe teknologjinë e duhur për pranimin e ankesave e informacioneve që jep publiku dhe subjektet e ndryshme;

- administrojë e trajtojë me përgjegjësi e objektivitet të gjitha ankesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme (qytetar, media, institucione, organizma etj.), duke bërë verifikimin, hetimin dhe dokumentimin nëpërmjet akteve përkatëse, sipas legjislacionit që rregullon çështjen e ankimuar, atë mbi dhe procedurat administrative, civile e penale, si dhe t'u përgjigjet ankuesve në kohën e duhur;

- analizojë në vazhdimësi problematikën e ankesave, vlefshmërinë e tyre dhe mënyrat e zgjidhjes, shkaqet e sjelljeve, veprave korruptive dhe veprimeve të kundërligjshme të punonjësve dhe rekomandojë strukturave vendimmarrëse masa e alternativa pune për ndryshim të gjendjes, si dhe informojë opinionin publik në mënyrë periodike.

OBJEKTIVI 4.3

Inspektimi i strukturave për të parandaluar shkeljet ligjore në ushtrimin e autoritetit dhe të kompetencave të dhëna nga ligji.

Ligji organik i jep SHÇBA-së përgjegjësinë të inspektojë strukturat, për: "zbatimin e ligjshmërisë, përmbushjen e detyrave, administrimit të provës, pajisjeve dhe teknologjisë, si dhe burimet njerëzore dhe financiare" (neni 63); "të bëjë rekomandime për drejtuesit e PSH-së për çështje të zbatimit të ligjshmërisë dhe për parandalimin e shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës së punonjësve të strukturave".

- Synimi i inspektimit është të kalohet nga puna për zgjidhjen e ankesave e incidenteve të veçanta, tek evidentimi dhe zgjidhja e problemeve institucionale (sistemeve) që kanë të bëjnë me komunikimin e sjelljen, shërbimet e ndryshme, procedurat ligjore, qëndrimet që mbahen ndaj shkeljeve e veprimeve korruptive etj.

- Inspektimi do të zhvillohet duke u përqendruar, në:

a) synime e objektiva konkretë për drejtime e shërbime që rezultojnë problematike nga analiza e informacionit dhe e ankesave të qytetarëve e e subjekteve të ndryshme;

b) drejtime e forma të ndryshme të krimeve me tendencë në rritje, ku forca zbuluese është e ulët dhe konkludohet se strukturat janë familjarizuar e kompromentuar me gjendjen;

c) çështje e ngjarje konkrete me pasoja të rënda që implikojnë shërbimet dhe punonjësit e zbatimit të ligjit dhe kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik;

d) bashkëpunimin me autoritetet drejtuese, sipas niveleve, duke u përfshirë edhe gjatë ushtrimit të kontrollit hierarkik që bëjnë vetë strukturat e strukturat e ndryshme.

-Në varësi të gjetjeve nga inspektimi, Shërbimi informon pranë drejtuesve të strukturave e strukturave, duke bërë edhe rekomandimet përkatëse për procedimet e mëtejshme (disiplinore, administrative, penale) dhe masat që duhen marrë për shmangien e rreziqeve dhe eliminimin e pasojave.

OBJEKTIVI 4.4

Hetimi i shkeljeve të ligjit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale të kryera nga punonjës të strukturave shtetërore që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit.

Zbulimi dhe hetimi i veprave penale që lidhen me abuzimin në detyrë dhe korrupsionin është një nga përgjegjësitë kryesore të SHÇBA-së, që ndikon direkt në performancën e Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera, si dhe në imazhin e besimin ndaj këtij Shërbimi.

- Veprimtaria për zbulimin dhe hetimin e korrupsionit dhe të veprave të tjera penale bazohet në ligjin për SHÇBA-në, atë për Policinë Gjyqësore, Kodin e Procedurës Penale dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore. Legjislacioni i jep Shërbimit:

a) pushtetin (autoritetin) e Shërbimit informativo-gjurmues dhe atë të Policisë Gjyqësore;

b) e autorizon të përdorë kompetenca, mjete ligjore dhe procedura të caktuara.

- Gjatë procesit të hetimit, strukturat përkatëse, në përshtatje me natyrën e shkeljes ligjore (disiplinore, administrative apo penale) duhet të respektojnë parimet dhe procedurat përkatëse, të shprehura në Kodin e Procedurës Administrative e atë të procedurës penale; ku përfshihen edhe parimi i garantimit të një procesi të drejtë hetimor dhe ai i prezumimit të pafajësisë, deri sa të shprehet me vendim gjykata përkatëse.

Veprimtaria për zbulimin dhe për hetimin e veprave penale e autorëve të tyre do të realizohet, duke:

- përforcuar strukturat për hetimin e krimit; vlerësuar nivelin profesional të personelit përpara caktimit në detyrë; kualifikuar me program të veçantë në vazhdimësi, si dhe pajisur me mjetet dhe teknologjinë e nevojshme për punë;

- administruar dhe përdorur informacionin për njohjen e situatës së paligjshmërisë dhe elementeve të tjera që lidhen me format, metodat, shërbimet, vendin, kohën, punonjësit që abuzojnë me detyrën dhe kompetencat;

- fokusuar punën për ruajtjen e pastërtisë së strukturave e punonjësve dhe zbulimin e veprimeve korruptive në të gjitha strukturat e strukturave, e veçanërisht tek ato me risk të lartë korrupsioni, si në qarkullimin rrugor, policinë kufitare, sektorët e burimeve njerëzore, krimit ekonomiko-financiar dhe atij të organizuar (droga dhe trafiqet), Shërbimit ndaj të tretëve etj.

- zhvilluar hetime proaktive, nëpërmjet:

a) ndjekjes me përparësi të korrupsionit, përfshirjes apo favorizimit (me veprime e mosveprime) të krimit të organizuar, kultivimit e trafikimit të bimëve/lëndëve narkotike, trafiqet e ndryshme etj.;

b) shfrytëzimit të produkteve të analizës së informacionit e të dhënave të tjera që lidhen me vepra kriminale e subjekte të dyshuara për kryerjen e tyre;

c) rritjes së ngarkesës me punë të specialistëve e drejtuesve dhe profesionalizmit në kryerjen e detyrave, përdorimin e mjeteve ligjore dhe metodave shkencore në hetimin e krimit;

d) bashkëpunimit me Prokurorinë, duke analizuar në mënyrë të rregullt materialet dhe çështjet në ndjekje, si dhe raportuar te ky organ për realizimin e funksioneve e detyrave të Policisë Gjyqësorë;

e) përdorimit me profesionalizëm të mjeteve ligjore dhe të metodave shkencore për sigurimin e provave dhe dokumentimin e tyre;

f) bashkëpunimit me strukturat e agjencive të tjera informative, si: SHISH-in, Policinë Kriminale e, veçanërisht, strukturat që merren me luftën kundër korrupsionit; institucionet e tjera, si: ILDKP-në, Agjencinë e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme, doganat e tatimet etj.

KAPITULLI IV
BUXHETI

SHÇBA-ja ka buxhetin e vet që është një zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Brendshme, por për administrimin e tij nuk ka pavarësinë e plotë. Varësia nga ministria për menaxhimin e burimeve financiare, materiale e teknologjike është një minus në standardet e shërbimit, i cili ndikon edhe në treguesit e punës që ai realizon.[35]

[35] Raport i vlerësimit të jashtëm ICITAP.

Buxheti i planifikuar për shërbimin në vitet e fundit ka shënuar rritje, por në fushën e investimeve shifra është e pamjaftueshme në raport me nevojat për mjediset e kushtet e punës dhe teknologjinë në përdorim.

Mosmbështetja me burimet e duhura financiare për plotësimin e kushteve të teknologjisë, kanë ndikuar dukshëm në klimën e rekrutimit të personelit, si dhe në treguesit e veprimtarisë së këtij Shërbimi. Duke vlerësuar:

- gjendjen aktuale të SHÇBA-së, i cili nuk ka kushte normale pune, mjedise, pajisje, mjete lëvizjeje e komunikimi etj. dhe po kështu nuk administron teknologji e programe bashkëkohore për proceset e punës e konkretisht:

- Shërbimi nuk ka godinë të vetën për sigurimin e kushteve optimale për punë. Për rikonstruksionin e godinës së Arkivit të Ministrisë së Brendshme, efektet financiare fillestare janë në vlerën e 43.400 mijë lekë.

Për rikonstruksionin e kësaj godine, në buxhetin e vitit 2020 SHCBA-së i është alokuar fond investime në vlerën 21.400 mijë lekë. Në këto kushte efektet financiare për rikonstruksionin e godinës së re janë në masën 22.000 mijë lekë, diferencë e vlerës totale. Pra, në total nga 120.000 mijë lekë të parashikuara për ndërtimin e godinës së re, efektet buxhetore për godinën janë në masën 22.000 mijë lekë ose rreth 82% më pak se vlera e parashikuar në projekt strategji.

- Shërbimi ka problematikë të theksuar në infrastrukturën teknologjike.

- Aktualisht, Shërbimi nuk ka databazë për Menaxhimin e Çështjes, Menaxhimin e Informacionin apo Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Në bashkëpunim me ICITAP-in, programi për Menaxhimin e Çështjes, nëpërmjet të cilit do të menaxhohet veprimtaria administrative dhe penale e Shërbimit, do të ofrohet pa asnjë kosto financiare nga ICITAP-i, projekt i cili do të implementohet brenda vitit 2020.

Ndërkohë që, për programet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Menaxhimin e Informacionit kërkohet, duhet të financohen nga Buxheti i Shtetit.

- Objektin e shtuar të punës; përgjegjësitë dhe objektivat e caktuar në këtë dokument strategjik e programe të tjera shtetërore.

- Praktikën disavjeçare të buxhetimit në nivele të ulëta, i cili nuk ka mbështetur plotësisht realizimin e detyrave të shtruara, është e nevojshme:

Së` pari: të ndryshojë Politika e buxhetimit për Shërbimin, e cila duhet të jetë në harmoni me detyrimet e përcaktuara në ligj dhe programet e punës (pra jo sipas mundësive që ka ministria) dhe në mbështetje të tyre për të realizuar misionin dhe përgjegjësitë.

Së dyti: të bëhet një investim prioritar *(extra),* mbi bazën e nevojave e të projekteve përkatëse për krijimin e kushteve dhe instalimin e teknologjisë së re, për të motivuar punonjësit, ndryshuar imazhi i Shërbimit dhe eficienca në detyrat e ngarkuara.

KAPITULLI V
ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

V.1 Përgjegjësitë për zbatimin e Strategjisë

Ky dokument i nivelit strategjik dhe Plani i veprimit që e shoqëron, materializojnë vizionin, objektivat dhe politikat shtetërore që do të ndiqen për zhvillimin e standardeve të Shërbimit dhe rritjen e treguesve të punës.

- Zbatimi i strategjisë dhe i planit të veprimit për ndryshimin e standardeve të SHÇBA-së kërkon zbërthim në plane të tjera, sipas strukturave e përgjegjësive të ngarkuara; harmonizim të politikave të zhvillimit me ato të Ministrisë së Brendshme, PSH-së e strukturave të tjera; agjencive ligjzbatuese dhe sistemin e drejtësisë; si dhe mbështetje prioritare me buxhet nga strukturat përgjegjëse.

- Autoriteti përgjegjës politik për zbatimin e Strategjisë së SHÇBA-së është ministri i Brendshëm dhe struktura të tjera që merren me politikat në fushën e sigurisë publike dhe burimet që nevojiten.

- Përgjegjësia administrative për realizimin e kësaj strategjie është e drejtorit të SHÇBA-së dhe e drejtuesve të tjerë nga niveli qendror e deri në bazë, të cilat duhet të udhëheqin gjithë procesin e ndryshimit të infrastrukturës ligjore e organizative dhe njëherësh të drejtojnë nga afër Shërbimin për kryerjen e detyrave kundër paligjshmërisë dhe veprimeve korruptive.

- Kjo kërkon planifikim për sigurimin e personelit të nevojshëm me standardet e duhura profesionale; krijimin e kushteve të punës dhe

kompletimin e mjediseve e teknikës së Shërbimit; sigurimin e buxhetit të nevojshëm për të plotësuar nevojat e Shërbimit dhe të drejtat e punonjësve.

- Është përgjegjësi dhe detyrë e autoriteteve drejtuese të SHÇBA-së dhe strukturave të tjera, që në përshtatje me kushtet konkrete e veçoritë e shërbimeve, të:

a) zbërthejnë strategjinë me strukturat vartëse; strukturat që përfshihen në objektin e veprimtarisë; partnerët ndërkombëtarë, si dhe aktorë të tjerë shtetërorë e shoqërorë;

b) ndërtojnë planifikimin përkatës, sipas prioriteteve dhe objektivave të përcaktuar (të nivelit taktik e operacional);

c) hartojnë programet dhe projektet e ndryshme (ligjore, organizative, materiale, financiare, teknologjike), sipas përcaktimit në dokument dhe nevojave:

- ekipi drejtues i Shërbimit, që do të merret me implementimin e ndryshimeve ligjore e organizative, duhet të njohë mirë vizionin dhe objektivat e përcaktuar, si dhe burimet, instrumentet dhe procedurat që do të ndiqen;

- menaxhimi i nivelit të lartë gjatë implementimit të kësaj Strategjie duhet të ndjekë me vëmendje vështirësitë, pengesat dhe shkaqet e rezistencës, si dhe të marrë masa për shmangien e tyre;

- për ndjekjen nga afër të realizimit të detyrave dhe koordinimin e masave do të ngarkohet një nga zëvendësdrejtorët e përgjithshëm, i cili duhet të bashkëpunojë me drejtorinë përkatëse të politikave të sigurisë dhe atë të programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator në ministri;

- miratimi dhe zbatimi i strategjisë së zhvillimit të SHÇBA-së do të bëhet në dy faza:

Në fazën e parë (vitet 2020–2021) do të punohet, për:

Vlerësimin e Shërbimit (i brendshëm dhe i jashtëm), përgatitjen e projektdokumentit strategjik të zhvillimit; diskutimin, zbërthimin dhe miratimin e tij; planifikimin e masave dhe të detyrave, sipas strukturave e drejtimeve për përgatitjen e paketës ligjore e organizative dhe programeve e projekteve të planifikuara etj.

Në fazën e dytë (vitet 2022–2024) do të punohet, për:

Kompaktësimin e Shërbimit, duke zbatuar plotësisht infrastrukturën e re ligjore e organizative, kompletuar burimet njerëzore dhe kushtet e punës me resurse cilësore, programe të reja teknologjike në funksion të Shërbimit, si dhe trajtim financiar motivues.

V.2 Monitorimi i realizimit të Strategjisë

Monitorimi i zbatimit të strategjisë bazohet në ligjin organik dhe aktet e tjera nënligjore.

- Në pushtetin ekzekutiv, institucioni përgjegjës që vlerëson performancën e SHÇBA-së është Këshilli i Ministrave dhe Kryeministri. Nëpërmjet ministrit përkatës apo organizmave të tjerë të caktuara me ligj, kontrollojnë zbatimin e këtij dokumenti të miratuar, si dhe gjithë legjislacionit e programeve të ndryshme ndërministrore.

- Institucioni direkt përgjegjës për monitorimin dhe për vlerësimin e zbatimit të kësaj strategjie është ministri i brendshëm, i cili nëpërmjet funksionarëve të tij dhe drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit, ndjek në vijimësi realizimin e objektivave dhe performancës në tërësi dhe njëherësh përcakton objektiva të tjerë për Shërbimin.

- Në pushtetin legjislativ, përgjegjësinë për të kontrolluar veprimtarinë dhe për të vlerësuar performancën e ka Kuvendi dhe Komisionet Parlamentare përkatëse, të cilat ndjekin realizmin e objektivave, zbatimin e ligjshmërisë e të të drejtave të njeriut, nivelin e standardeve të sigurisë etj.

- Veç sa më lart, detyrimin dhe të drejtën për të ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e Shërbimit në fushën e përdorimit të buxhetit, janë Auditi i Brendshëm në Ministrinë e Brendshme dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Të drejtën për të kontrolluar zbatimin e ligjit dhe të drejtave e lirive themelore të shtetasve në veprimtarinë administrative e ka edhe Avokati i Popullit, si institucion i pavarur kushtetues.

- Vlerësimi i realizimit të strategjisë bazohet në të dhënat e administruara në statistikat zyrtare të Shërbimit dhe dokumente të tjera, si: analiza, raporte dhe studime të bëra, si dhe në anketimet e opinionit publik për shërbimet që i ofrohen.

- Treguesit e performancës së Shërbimit janë të ndërvarur nga realizimi i përgjegjësive ligjore dhe objektivave të planifikuar (sipas instrumenteve të përcaktuara), të cilët mund të përmblidhen në parandalimin (uljen) e shkeljeve ligjore dhe ankesave për shërbimet, parandalimin (uljen) dhe ndëshkimin e veprave penale, mbrojtjen e integritetit dhe veprimtarisë së rregullt të strukturave (rritjen e vlerësimit të qytetarëve).

- Për vlerësimin e standardeve të Shërbimit do të përdoren teknika bashkëkohore, të cilat mbështeten në hartën e proceseve të monitorimit të objektivave strategjikë, duke u fokusuar në realizimin e indikatorëve dhe objektivave kryesorë të planifikuar në planin e veprimit, si dhe në impaktin e tyre në opinionin publik.

- Për treguesit e reformës do të përgatitet raport i veçantë çdo gjashtëmujor për ministrin e Brendshëm dhe vjetor për Kryeministrin dhe komisionet parlamentare, për t'i njohur me progresin dhe problematikën e dalë.

V.3 Vlerësimi i performancës

Indikatorët dhe treguesit e performancës përcaktohen nga institucionet dhe autoritetet që kanë përgjegjësinë e monitorimit të SHÇBA-së dhe veprimtarisë së tij.

TREGUESIT E MATSHËM TË PERFORMANCËS
(SIPAS PRIORITETEVE DHE OBJEKTIVAVE)

Nr.	Përshkrimi i treguesve	Viti bazë 2020	Synimi afatmesëm 2022	Synimi afatgjatë 2024	Realizimi treguesve
A. Forcimi i integritetit të strukturave ligjzbatuese në Ministrinë e Brendshme (Vetingu), për të mbrojtur e për të pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e strukturave dhe të punonjësve, sipas kritereve e procedurave të përcaktuara në legjislacion.					
1.	Hartimi i akteve nënligjore për procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik dhe dërgimi i tyre për miratim brenda vitit 2020	**Brenda vitit 2020**			
2.	Hartimi përshkrimeve të punës për çdo post pune pas riorganizimit të Drejtorisë se Pastërtisë së Figurës dhe Monitorimit të Brendshëm.	**Brenda vitit 2020**			
B. Zhvillimi i standardeve të SHÇBA-së, për të krijuar një shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe të parimeve demokratike, të hapur, dinamik, të besueshëm, efikas dhe eficient, transparent e të kontrollueshëm.					
1.	Rishikimi i bazës ligjore që rregullon veprimtarinë e shërbimit në fushën informativo-gjurmuese, procedurale, inspektimit dhe trajtimit të ankesave, e konkretisht.	**Brenda vitit 2020**			
2.	Ngritja e grupit të punës për identifikimin e nevojave për burime njerëzore në nivel qendror e rajonal.	**Brenda vitit 2020**			
3.	Përmirësimi i procesit të rekrutimit të punonjësve me gradë dhe punonjësve civilë të shërbimit.	**Brenda vitit 2020**			
4.	Hartimi dhe përmirësimi i kurrikulës së trajnimeve të vazhdueshme e të trajnimeve specifike.	**Brenda vitit 2020**			
5.	Përmirësimi i sistemit të vlerësimit individual të punës.	**Brenda vitit 2020**			
6.	Përmirësimi i sistemit të promovimit.		**Brenda vitit 2022**		
7.	Përmirësimi i sistemit të trajtimit dhe të shpërblimit të punonjësve.		**Brenda vitit 2022**		
8.	Do të hartohet detyra e projektimit për kapacitetet e godinës së re të Shërbimit.	**Brenda vitit 2020**			
9.	Do të kryhen procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e projektit.	**Brenda vitit 2020**			
10	Do të kryhen procedurat e marrjes së lejes së ndërtimit.	**Brenda vitit 2020**			
11	Do të kryhen procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë ndërtuese.	**Brenda vitit 2020**			
12	Do të ndiqen procedurat e ndërtimit të godinës.	**Brenda vitit 2020**			
13	Do të kryhen procedurat e planifikimit të nevojave për mobilim.	**Brenda vitit 2020**			
14	Do të bëhet rinovimi i mjeteve të transportit të SHÇBA-së.		**Brenda vitit 2022**		
15	Ngritja e rrjetit të intranetit (pajisjet e Enkriptimit).		**Brenda vitit 2022**		
16	Blerje licence për antivirus.		**Brenda vitit 2022**		
17	Krijimi i sallës së monitorimit.		**Brenda vitit 2022**		
18	Blerje pajisjeje speciale, përgjimi, vëzhgimi, fotografimi, monitorimi etj.		**Brenda vitit 2022**		
19	Blerje programi analizim të dhënash (IBASE).		**Brenda vitit 2022**		
20	Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të armatimit.		**Brenda vitit 2022**		
21	Implementimi i sistemit të Menaxhimit të Çështjes në SHCBA-së.	**Brenda vitit 2020**			
22	Program për profilin e integritetit.		**Brenda vitit 2022**		
23	Program për komunikatat dhe buletinit mujor.	**Brenda vitit 2020**			
C. Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit, si dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet objekt i veprimtarisë së shërbimit, opinionin publik dhe institucione të tjera publike e jopublike.					
1.	Hartimi dhe zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis SHÇBA-së dhe Policisë së Shtetit.		**Brenda vitit 2022**		
2.	Hartimi dhe rishikimi i marrëveshjeve të përbashkëta me prokuroritë, doganat dhe institucione të tjera ligjzbatuese etj.	**Brenda vitit 2020**	**Brenda vitit 2022**		
3.	Hartimi dhe rishikimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të rajonit, si: KosovëN, Maqedoninë e Veriut, Malin		**Brenda vitit 2022**		

Nr.	Përshkrimi i treguesve	Viti bazë 2020	Synimi afatmesëm 2022	Synimi afatgjatë 2024	Realizimi treguesve
	e Zi etj.				
4.	Përgatitja e Hartës së Analizës së Riskut, identifikimi i rrezikut, vlerësimi riskut dhe masat për të parandaluar dhe për të luftuar riskun e korrupsionit në bashkëpunim me misionin ICITAP/ PAMECA V, OSBE etj.	**Brenda vitit 2020**			
5.	Takime në qarqet Shkodër, Vlorë, Durrës, Elbasan dhe Korçë me grupe target nxënësit e shkollave të mesme, studentët e universiteteve publike dhe private në këto qarqe dhe me qytetarë në pikat e kalimit kufitar, që mbulojnë këto qarqe Shpërndarjen e fletëpalosjeve me informacion mbi SHÇBA-në.	Shkodër, Vlorë	Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër	Tiranë, Lezhë, Kukës, Dibër, Fier, Berat	
6.	Riformatimi dhe përdorimi i faqes së internetit të SHCBA-së, për pasqyrimin në mënyrë të vazhdueshme me; - informacion për treguesit e punës, ngjarjet e renda me interes; - pjesëmarrjen në krim e korrupsion të subjekteve, si dhe të studimeve e anketimeve të kryera.	**Brenda vitit 2020**			
7.	Anketim i kënaqësisë së qytetarëve, në lidhje me trajtimin e ankesave.		**Brenda vitit 2022**		
8.	Realizimi i anketimit në universitet, Shkolla të Mesme dhe qendra biznesi, në disa rrethe të ndryshme të vendit.	Shkodër, Vlorë	Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër	Tiranë, Lezhë, Kukës, Dibër, Fier, Berat	
